

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7569 E diel 24 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga MIRON ÇAKO



Një varrezë të lashtë u gjet diçka e pazakontë, në pllakat e varrit ishin shkruar jo vitet e jetës së personit të vdekur, por minutat dhe orët. Ata që kishin vdekur ...
Vijon në faqen 21

A ekziston lumturia dhe ku mund ta gjejmë atë?

Opinion

Ditës

Nga ARDIAN VEHBUI

Që nga koha e Athinës klasike, teatri ka shërbyer si hapësira magjike, ku riprodhohet qyteti. Protesta e tanishme po i jep Tiranës një hapësirë po aq magjike ...
Vijon në faqen 22

Protesta për teatrin – mendime të shkurtisura



Eventi i "Moët & Chandon Ice Imperial"

Veshje të bardha e shampanjë franceze, VIP-at dehen në "Prestige Resort"

Personazhe të njohura të artit, medias dhe biznesit në "brunch"-in buzë detit

Një event mbresëlënës i organizuar buzë detit në Durës, ka bërë bashkë personazhe të njohura të botës së medias, artit e biznesit në vend. Të veshur në të bardha, në një ambient të arduar në mënyrë mbresëlënëse ku dominonte po ngjyra e bardhë, të pranishmit kanë shijuar brunch-in special nga "Moët & Chandon ...
Në faqen 10

KRYEMINISTRI: JEMI NE NEGOCIATA, DO KETE TARIFAT ME TE ULETA NE RAJON

AEROPORTI I VLORES, RAMA: HAPEN MIJERA VENDE PUNE

Të rinjtë e PD e presin me pankarta, Rama: Menjëherë 1 mijë të punësuar, shpejt do nisin punimet. Thirrje kompanive: Tregoni pagat reale të punonjësve



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të projekteve në qarkun e Vlorës

Në faqen 4

—MENAXHIM EMIGRACIONIT—

Xhafaj e Veliu në Berlin, takime me krerët e policisë federale gjermane

Në faqen 11

—AMBASADORI I SHBA—

Donald Lu: Vetingu sukses, gjykatat ishin peng nga të korruptuarit

Në faqen 3

—INTERVISTA—

Edmond Spaho: Nëse s'hapen negociatat, opozita do reagojë fort ndaj qeverisë

Në faqen 2

MILSOO Zbulohet punimi i arkitektit Stavri Opari paraqitur në Bukuresht

Një projekt për Teatrin e viteve '30, pa kullë

Në brendësi: Kur Skënderbeu merrte borxh. Poezi nga Moikom Zeqo

Suplement



Të gjitha përfitimet në një zgjidhje!
Sigurimi i jetës dhe shëndetit Cash Plan

Me Cash Plan ju përfitoni:

- Mbulim të shpenzimeve mjekësore
- Kontroll të vazhdueshëm të shëndetit tuaj

8 PAKETA STANDARDE
PËR SIGURIMIN E JETËS



SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete
Në duar të sigurta!

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5,
Rr. "Brigada VIII", Vllë Nr. 3/1, Tiranë
Tel: +355 42 237 549 / +355 69 20 84 026
Email: shifte@sicred.com.al

NEGOCIATAT VENDIMI

Nënkryetari demokrat: Rikthimi i PD në pushtet përmes garantimit të votës së lirë

Spaho: Nëse shapen negociatat, opozita do të reagojë fort

"Kthim pas, edhe në 2016 negociata me kushte"

Valentina Madani

Nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho beson se një qeveri, ku janë bërë bashkë krimi i organizuar me qeveritarët, nuk mund të pranohet në Europë. Zyrtaari i lartë demokrat përmes se për shkak të keqqeverisjes së majtë, Shqipëria ka bërë kthim pasi edhe në vitin 2016, u kërkua hapje negociatash me kushte. Por Spaho thotë për "Gazeta Shqiptare" se, nëse negociatat nuk hapen, marrëdhëniet politike nuk mund të jenë si më parë. Kreu i deputetëve demokratë paralajmëron se në rast se nuk hapen negociatat do të reagojë fort dhe se asgjë nuk do të jetë më si më parë. Z.Spaho flet edhe për çështjen "Xhafaj", sipas të cilit beteja vazhdon që kohë sa drejta ministrinë e Brendshme ndërsa rikthimin e PD-së në pushtet e shih përmes garantimit të votës së lirë.

Z.Spaho, çfarë paralajmëroni përmes letrës së përbashkët që mban dhe firmën e kreu të Grupit Parlamentar të LSI-së, z.Petrit Vasili për momimin e të drejtës së fjalës në Kuvend pas seancës së fundit plenare?

Rasti sikurse theksojmë në letrë është i rëndësishëm dhe i paprecedent. Maxhoranca me forcën e numrave në Kuvend merr vendim nëse do lejohet opozita të flasë ose jo. A e kuptoni se ku kemi arritur? Kjo ngjet vetëm në diktatura, të cilat mbajnë një opozitë fasadë. Kështu si u veprua ditën e enjte praktikisht i është dhënë fund rendit demokratik dhe kushtetues. Nëpërmjet letrës në informojmë publikun e gjerë dhe komunitetin ndërkombëtar, por paralajmërojmë maxhorancën se do të përballim me reagimin tonë më të ashpër



Nënkyetari i PD-së, Edmond Spaho

PARALAJMËRIMI

"Sigurisht, nëse negociatat nuk hapen, marrëdhëniet politike nuk mund të jenë si më parë. Opozita do reagojë për këtë. Format dhe mënyrat e reagimit do bëhen të njohura pas konsultimeve brenda spektrit opozitar", -tha z.Spaho.

të mundshëm dhe më të gjitha mjetet.

Në Kuvend, kreu i PD, Lulzim Basha njoftoi se Gjermania ka vendosur të mos hapë negociatat me vendin tonë. Konkretisht çfarë informacionesh ka PD lidhur me këtë çështje nga vendet skeptike?

Qëndrimet e vendeve skeptike janë bërë publike nga vetë këto vende. Gjermania është shprehur për hapje të negociatave pa kushte me Maqedoninë dhe për Shqipërinë ka vendosur 10 kushte që fillojnë nga reforma zgjedhore, përmirësimi i klimës politike me opozitën, lufta ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe dënimi i politikanëve të lartë, përfundimi i vetingut për gjykatat e apelit dhe më sipër, krijimi i Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë, krijimi i SPAK, dekanabizimi i vendit, etj. E veçanta është që kushtet nuk kanë afat dhe kontrolli i plotësimin të tyre nuk do lihet Komisionit Europian, por Qeverisë Federale dhe Bundestagut. Kjo gjë nuk ka ndodhur ndon-

jëherë në historinë e zgjerimit të BE. Franca dhe Holanda janë edhe më skeptike dhe nga sa janë shprehur autoritetet e këtyre vendeve janë kundër hapjes së negociatave për shkak se qeveria shqiptare nuk ka bërë mjaftueshëm në drejtim të luftës ndaj krimin të organizuar, korrupsionit dhe azilantëve për të cilët

PD-ja i ka fituar të dy betejat edhe atë me Tahirin edhe atë me Xhafajn. Ne kemi bërë betejë dhe do vazhdojmë ta bëjmë atë sa kohë që Xhafaj të jetë ministër i Brendshëm", - theksoi zyrtari i PD-së.

ja kalojmë edhe Sirisë në konflikt. Nga sa është njoftuar në media parlamenti holandez votoi me shumicë dërrmuese për mos hapjen e negociatave me Shqipërinë.

Çfarë e pengon hapjen e negociatave me 28 qershor?

Mosrealizimi i reformave dhe mosplotësimi i detyrave nga qeveria e Edi Ramës. Fakti që koalicioni qeverisës në Gjermani vendos 10 kushte do të thotë që ata janë të pakënaqur me përparimet e Shqipërisë dhe dëshirojnë të shohin progres të vërtetë dhe jo gënjeshtër e Edi Ramës. Një qeveri ku janë bërë bashkë krimi i organizuar me qeveritarët nuk mund të pranohet në Europë.

Kur besoni se do të bëhet i mundur momenti i hapjes së negociatave?

Kjo është pyetje për maxhorancën, por sikurse u shpreh më sipër negociatat mund të hapen kur të ketë progres substancial dhe të qartë në reformat e nevojshme dhe kushtet e vëna nga vendet e BE.

Opozita ka paralajmëruar se, nëse BE refuzon hapjen e negociatave, atëherë marrëdhënia e saj me qeverinë do të ndryshojë. Çfarë do të ndodhë konkretisht nëse Shqipërisë i refuzohet hapja e negociatave?

Sigurisht nëse negociatat nuk hapen, marrëdhëniet politike nuk mund të jenë si më parë. Mos harroni që hapje të negociatave me kushte kemi marrë në vitin 2016. Nëse vendikti është i njëjtë dhe kushtet shtohen jo vetëm që kemi çuar dy vjet dëm, por kemi bërë hapa prapa që do të thotë me Ramën nuk kemi të ardhme. Opozita do reagojë për këtë. Format dhe mënyrat e reagimit do bëhen të njohura pas konsultimeve brenda spektrit opozitar.

Cila është strategjia e opozitës për largimin e



KUSHTET

"E veçanta është që kushtet nuk kanë afat dhe kontrolli i plotësimin të tyre nuk do lihet Komisionit Europian, por qeverisë Federale dhe Bundestagut. Kjo gjë nuk ka ndodhur ndonjëherë në historinë e zgjerimit të BE", -tha nënkryetari i PD-së.

qeverisë, përmes zgjedhjeve të parakohshme apo zgjedhjeve normale?

Para se të diskutojmë se me çfarë zgjedhesh do ta largojmë Ramën duhet të garantojmë që të ketë zgjedhje. Me Ramën sikurse e ka treguar qartë dhe hapur në të gjitha rastet nuk ka zgjedhje të lira e të ndershme, kështu që beteja e parë e opozitës do të jetë që t'i garantojë vendit zgjedhje të lira dhe të ndershme.

A do ketë një koalicion PD-LSI për zgjedhjet lokale?

Do të vendosim në kohën e duhur. Sot nuk përbën prioritet pasi, sikurse theksova, duhet të garantojmë së pari, që të ketë zgjedhje. PD fitoi betejën ndaj Saimir Tahirit, por siç duket jo ndaj Fatmir Xhafajt. A e ka mbyllur tashmë opozita çështjen "Xhafaj"?

PD-ja i ka fituar të dy betejat edhe atë me Tahirin edhe atë me Xhafajn. Nuk është përgjegjësia e opozitës që nuk shkarkohet Xhafaj, por e maxhorancës dhe Edi Ramës që mban ministër të Brendshëm një individ që ka vëllain të dënuar për formim organizatash kriminale dhe trafik ndërkombëtar drogë. Ne kemi bërë betejë dhe do vazhdojmë ta bëjmë atë sa kohë që Xhafaj të jetë ministër i Brendshëm.

Çfarë faktesh të reja disponon PD për denoncimin e lidhjeve të qeverisë me krimin? Kur do të publikohen ato?

Nuk ka nevojë për fakte të reja që të bindësh që kjo qeveri është e kriminalizuar. Kjo vlen si për opinionin e brendshëm ashtu edhe për autoritetet ndërkombëtare. Opozita çdo gjë që disponon e vë në djepin e opinionin publik në momentin e nevojshëm.

Çfarë nënkupton "surpriza e madhe" për qeverinë e paralajmëruar nga kreu i opozitës, Lulzim Basha pak ditë më parë?

Nëse do të thuhej në avancë nuk do ishte surprizë dhe aq më tepër e madhe.

Përveç betejës ndaj qeverisë, a është e bashkuar vetë PD-ja brenda saj dhe zgjedhjet e brendshme a po ndihmojnë procesin e bashkimit të së djathtës?

Sipas përcaktimeve të Kuvendit të fundit dhe detyrimit statutor po zhvillohen zgjedhjet në strukturat e Partisë Demokratike për të përgatitur atë për betejat e ardhshme zgjedhore. Të gjithë ata të cilët e shohin PD-në si zgjidhje të problemeve që kalon vendi do ta gjejnë gjithmonë derën hapur, janë më se të mirëpritur të na bashkohen dhe kontributi i çdonjërit do vlerësohet maksimalisht.



Parlamenti Evropian

Reforma në drejtësi drejt dështimit?

Ambasadori Lu: Gjykatat mbaheshin peng nga të korruptuarit

NEGOCIATAT

Ende nuk është arritur një marrëveshje konkrete për detin mes Greqisë dhe Shqipërisë. Edhe dje pas raundit të tretë të bisedimeve mes grupeve negociatore ende nuk ka një dokument të shkruar për delimitimin e zonave detare. MPJE njoftoi se takimi ishte konstruktiv dhe në një klimë pozitive.



kishin integritetin e duhur për t'i shërbyer drejtësisë në Shqipëri. Disa njerëz e kanë kritikuar procesin, sepse ka penguar funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Unë nuk mendoj kështu. Ishte korrupsioni që pengoi funksionimin e këtyre gjykatave për vite me radhë. Vetingu po e ndreq këtë. Së shpejti Shqipëria do të ketë një sistem me gjykatës dhe prokurorë të pastër, që e kanë kaluar vetingun. Ai sistem është e ardhmja e Shqipërisë", - shprehet ambasadori Lu.

Ambasadori i SHBA në vendin tonë Donald Lu, e vlerëson ecurinë e procesit të vetingut në vendin tonë. I pyetur nga "BalkanWeb" lidhur me pretendimet e disa njerëzve që kanë thënë se "reforma në drejtësi po bllokoi sistemin e drejtësisë dhe po dështoi", ambasadori Lu ka shprehur qëndrimin e tij. Ai shprehet se me zbatimin e deritanishëm të procesit të vetingut, shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar, sepse nuk mundeshin të justifikonin pasurinë e tyre të madhe. "Vetingu po funksionon. Shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar, sepse nuk mundeshin të justifikonin pasurinë e tyre të madhe apo të tregonin se

Deputeti gjerman: Xhafaj të verifikojë veten, edhe Lu pati kritikë të fortë

Wadepful: Kampet për refugjatët në Shqipëri-ofertë pozitive



PE, Tajani:
Përfytyroj kampe refugjatësh në Shqipëri

Para samitit jozyrtar të BE për azilin, presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani theksoi se stabiliteti i Europës varet nga Gjermania. Tajani përfytyron mundësinë e kampeve në Shqipëri ose Maqedoninë e Veriut. Në një intervistë për "Funke Medien Gruppe" z.Tajani është shprehur, se "mënyra e veprimit me çështjen e migracionit nuk duhet të çojë në shpërbërjen e BE-së. Stabiliteti i Europës varet nga stabiliteti i Gjermanisë, tha Tajani. Ai është "kundër masave në kufijtë e brendshëm". Zgjidhja ndodhet jashtë, jo brenda Bashkimit Evropian. "Ne kemi nevojë për kampe jashtë BE." Tajani u shpreh se e përfytyron si të mundshme, që qendra të tilla të ngrihen në Shqipëri apo Maqedoninë e Veriut. "Por ne kemi nevojë për kampe edhe në Afrikë. Libia është një vend që duhet stabilizuar. Nigeria, Tunizia dhe Maroku janë po ashtu vende që mund të merren në konsideratë për kampe", -sipas Presidentit të PE.

CDU i thotë 'Po' Shqipërisë për negociatat. Megjithatë pas kësaj vjen 'por', deputeti i CDU-së, Johann Wadepful në intervistë për DW e sheh pozitiv ngritjen e kampeve të refugjatëve në Shqipëri.

Z. Wadepful, kemi një situatë të vështirë tani për Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst diskutohet edhe për çeljen e negociatave të Shqipërisë dhe Maqedonisë me BE. Pse është relevante Shqipëria?

Shqipëria ka rëndësi dhe as më pak e as më shumë se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, me të cilat Gjermania ndjehet shumë e lidhur. Deklaratat e Selanikut ne i kemi parë seriozisht dhe jemi të bindur se këto vende janë pjesë e Evropës dhe se ne edhe premtimet që kemi bërë nga ana evropiane duhet t'i mbajmë, edhe sepse konfliktet brenda jugosllave siç i kemi parë në vitet 90-të mund të rindizen në çdo kohë, e një proces i integritimit dhe anëtarësimit, siç ka ndodhur pjesërisht, pikërisht këto i shtensionon, prandaj kemi edhe një motivim të dyfishtë që të tregohet kujdes për këto vende.

Rekomandimi i grupeve parlamentare, CDU/CSU është formuluar me një qëndrim pozitiv për hapjen e negociatave duke përcaktuar qartë edhe hapat e mëtejshëm, si e komentoni ju?

Kemi nevojë për një vendim të Bundestagut. Këtë ne e kemi përgatitur prej vitesh



Deputeti i CDU-së Johann Wadepful

ÇËSHTJA "XHAFAJ".

"Unë besoj se ministri i Brendshëm i Shqipërisë duhet të pyesë veten, nëse mund ta përmbushë detyrën plotësisht i pavarur. Vëllai i tij është ekspozuar ndaj akuzave. Edhe ambasadori amerikan, që ka qenë mjaft miqësor ndaj qeverisë, në këtë rast ka ushtruar kritikë të fortë", -deklaroj deputeti gjerman.

dhe me shumë kujdes, ashtu si edhe për Serbinë. Në rastin e të dy vendeve, Bundestagu merr një vendim dhe qeveria gjermane që ka kontakt të ngushtë me të gjitha grupet parlamentare ka kërkuar të dijë se çfarë është e rëndësishme për ne. E rëndësishme për ne është që të themi Po, por edhe...Pra, po, duhet të fillohet me bisedimet për negociatat, por...

Cilat janë këto "por"....?

Ne kemi nevojë për një orientim më të qartë ndaj vlerave evropiane në disa fusha, marrëveshja e koalicionit e thotë qartë, se krizë duhet të plotësohen edhe në fillimin e negociatave, jo vetëm në anëtarësim. Kjo nënkupton një luftë më të ashpër kundër korrupsionit se deri më tani, se

të pyesë veten, nëse mund ta përmbushë detyrën plotësisht i pavarur: Vëllai i tij është ekspozuar ndaj akuzave. Dhe unë mendoj, se një person me një përgjegjësi të tillë duhet vetë të verifikojë, nëse mund ta kryejë detyrën i pavarur; nëse mund të drejtojë me përgjegjësi një proces në shtetin e së drejtës, kur ka akuzat të forta, dhe kur vëllai i tij është përballur me procese në Itali. Qeveria duhet të vendosë vetë, nëse ai është personi i duhur që e vazhdon këtë detyrë. Unë kujtoj, se edhe ambasadori amerikan, që ka qenë mjaft miqësor ndaj qeverisë, në këtë rast ka ushtruar kritikë të fortë.

Ka pasur edhe politikanë gjermanë që kanë thënë se nuk duhet të flasim kolektivisht, sepse akuzat janë drejtuar kundër vëllait të tij...

Po sigurisht, kjo është e drejtë, unë nuk jam instancë gjyqësore që jap një vendim për këtë, por ju i referoheni një sekretari shteti gjerman dhe unë jam pak i habitur, që një anëtar i qeverisë t'i parashtrijë parlamentit se ç'duhet të bëjë dhe këtë ne nuk do ta pranojmë.

Ka për momentin diskutime, dhe këtu është i kërkuar edhe ministri i Brendshëm i Shqipërisë, se Shqipëria mund të angazhohet duke ngritur vendet pranimi refugjatësh për azilkerkuesit e refuzuar apo si stacion i ndërmjetëm për refugjatët në kontekstin e Frontex-it. Si e shikoni rrugën që po ndiqet?

Unë e shoh si një propozim

interesant që më ka habitur, por mendoj se është një propozim i mirë, që duhet parë, kjo është një ofertë që mundësisht duhet edhe të realizohet. Ne e dimë se Shqipëria është treguar mjaft miqërisht edhe në krizën e atëherëshme në Kosovë, atëherë ishte një situatë tjetër, se bëhej fjalë për vëllezër e motra nga Kosova që flasin të njëjtën gjuhë e kanë të njëjtën kulturë. Në këtë rast do të ishte ndryshe, por si e thashë ky është një sinjal i mirë që duhet ndjekur.

Ky është edhe një propozim nga Austria, edhe nga presidenti i Këshillit të BE, Donald Tusk që Shqipëria të përfshihet më shumë e të mbështetet, e që do të ishte një zgjidhje jashtë BE-së, por brenda Europës. Janë më shumë teza se sa gjëra konkrete, çfarë do të bënit ju si CDU apo Gjermania për ta mbështetur këtë?

Ka dy gjëra, njëherë mendoj se qeveria shqiptare oferton e ka serioze, dhe se verifikon kushtet juridike dhe teknike në vend për zbatimin, por, nga ana tjetër, edhe Komisioni Evropian duhet ta mbështesë këtë masivisht, edhe financiarisht, por edhe nga ana logjistike. Të dyja palët ndeshen me një detyrë jo edhe aq të lehtë, por ndoshta do të bëhet një detyrë e përbashkët. Ne jemi të hapur, mund ta përfytyrojmë këtë, e shohim një ofertë pozitive dhe Komisioni Evropian duhet të zhvillojë bisedime me Shqipërinë.

PROJEKTET E QEVERISË AEROPORTI

Kryeministri paralajmëron kompanitë e mëdha: Të tregojnë pagat reale të punonjësve

Aeroporti i Vlorës nis nga puna, Rama: Do hapë mijëra vende pune

"Do të ketë tarifatat më të ulëta në rajon"

Kryeministri Edi Rama prezantoi dje projektet për Vlorën ndërkohë që u ndal tek fillimi së shpejti i punës për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. Ky aeroport sipas Ramës do të ketë tarifatat më të ulëta në rajon. Para qytetarëve të Vlorës theksoi se ndërtimi i aeroportit, do t'i jap një shtysë të madhe zhvillimit ekonomik, jo vetëm në këtë zonë, por gjithë Shqipërisë. Ai përmendi se vetëm në këtë projekt do punësohen rreth 1 mijë njerëz, ndërsa sipas tij tarifatat e fluturimit do të jenë më konkurrueset në rajon. "Në muajt në vijim do të fillojmë ndërtimin e aeroportit. Aeroporti në vetvete kërkon mbi 1000 forca pune. Nëse direkt në aeroport do të ketë mbi 1000 punësime, për shkak të aeroportit vlerësohet botërisht se rritja e punësimit është 1 me 27. Ne kemi kërkuar dhe jemi drejt përfundimit të negociatave që të kemi aeroportin e Vlorës, aeroportin me tarifatat më të ulëta në rajon", tha z.Rama. Krahas aeroportit të udhëtarëve Rama tha se ka kërkesë edhe për aeroport mallrash.

INVESTIMET

Investimet publike në këtë zonë kryeministri Rama i sheh si një domoshmëri jo vetëm në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve, por edhe turizmit e punësimit. Si deputet i këtij qarku me modesti përmendi një nga projektet që sikundër Sheshi "Skënderbej" u renditën ndër më të mirët në Barcelonë. Vlonjatëve u premtoi se nuk ka ndërmend të ndalet me investimet kur bëhet fjalë për zhvillimin turistik të kësaj zone, për ta kthyer atë një atraksion konkurrues në rajon. Një thirrje të veçantë pati për emigrantët, të cilët i ftoi të bëhen pjesë e investimeve të qeverisë në sektorin e agroturizmit. Pjesë e projekteve që qeveria ka parashikuar në këtë qark është edhe vijimi i ndërtimit të rrugës së Lumit të



Kryeministri Edi Rama dje në Vlorë

Vlorës, dy bypasset; ai i Fierit dhe Vlorës, ndërtimi i portit të jahteve në Orikum, i terminalit të kroçerave, shndërrimi i Bulevardit "Is-mail Qemali" në një shëtitore, rikualifikimi urban i qendrës historike të qytetit, si dhe nisjen nga puna të disa segmenteve rrugore, mes të cilave edhe rrugën turistike Orikum-Llogora.

PARALAJMËRIMI

Sfida e radhës e qeverisë është ajo me kompanitë private që nuk deklarojnë pagat reale për punonjësit e tyre. Z.Rama tha nga Vlorë se shumë kompani të mëdha deklarojnë pagë 300 mijë për punonjësit e tyre dhe kjo sipas tij nuk mund të jetë e vërtetë. Për pagat dhe informalitetin, ai paralajmëroi: "41% e të punësuarve në kompanitë e

PROJEKTI

Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij para qytetarëve në Vlorë ku ka prezantuar projektet për këtë qark është ndalur tek aeroporti i ri si një projekt që do të punësojë mijëra njerëz. Rama tha se të paktën nga ky projekt do të punësohen rreth 1 mijë njerëz.

mëdha figurojnë me pagë 300 mijë lekë. Kjo është gënjeshtër, nuk është e vërtetë. Nuk ka ekonomist, financiar, inxhinier dhe të tjerë të kësaj kategorie që punojnë në kompanitë e mëdha dhe marrin 300 mijë lekë. E vërteta është se kompanitë e regjistruar me 300 mijë lekë që të shmangin taksat". Duke folur për punësimin në vend, kryeministri vuri në dukje se vetëm në periudhën mars-maj 2018 janë bërë 10 mijë punësime të reja. "Nuk diskutohet që



Rama pritet me protesta në Vlorë, rrethohet nga policia

Në Vlorë kryeministri, u prit dje me protesta të organizuara nga PD-ja ku qytetarët mbanin në duar pankarta me mbishkrimin, "Edi Rama është peshku i madh". Protestuesit tentuan që të bëhen pjesë e aktivitetit të organizuar nga kryeministri, por nuk u lejuan nga Garda dhe policia. Mes protestuesve ishte dhe deputetja demokrate Nada Meçorapaj, e cila u kërkuar policëve që të hapin rrugën pasi nuk kanë motiv për t'i ndaluar Megjithatë policia nuk lëvizti. "Hape rrugën, o zotëri do kaloj", i drejtohet deputetja demokrate policëve, duke shtuar se nuk është e drejtë bllokada ndaj qytetarëve të Vlorës në një kohë kur kryeministri ka mbushur sallën me servilë.

sfida e punësimit është një sfidë komplekse. Kur flasim për një sfidë të vazhdueshme të punësimit jemi të vetëdijshëm se du-

het të përballemi me një sërë sfidash, që nga rritja ekonomike e deri tek sfida e deklarimit real të pagave", - u shpreh z.Rama.

"Zgjedhjet lokale, Ramës do t'ia vëmë gardhin tek thana"

Votimi elektronik, Bylykbashi: Projekt pilot në disa bashki për vendoret e 2019

kriminale për të mbledhur vota. Është thelbësisht e rëndë të themi të drejtë. Me këtë lloj indeksi që kemi në për zgjedhjet s'ka BE që të hapë negociatat", theksoi deputeti i PD. Në zgjedhjet ardhshme vendore propozohet zbatimi i një projekti pilot në disa prej bashkive të vendit, në mënyrë që të testohet votimi elektronik. Më pas sipas deputetit demokrat Oerd Bylykbashi, kjo mënyrë votimi, do të mund të implementohet në shkallë vendi në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Bylykbashi shprehu bindjen se me votimin elektronik do të shmanget blerja apo vjedh-



ja e votës, manipulimi i zgjedhjeve, apo standarde të tjera, të cilat janë shkelur deri më tani. "PD ka kërkuar votimin elektronik dhe identifikimin elektronik të votuesve që në 2016. Qëndrimi ynë është se në duhet të kemi një identifikimin bioelektronik përmes shenjes së gishtave, dhe komision-

Kërkesa

Duke u ndalur te procesi i integritimit evropian, deputeti i PD-së tha se BE do t'i kërkojë Shqipërisë si kusht për negociatat, realizimin e reformës zgjedhore.

erët nuk do të mund të mbushin kutitë më vota false. Edhe votimi elektronik do të bëjë të mundur që rezultati të shihet në mënyrë reale. Pa ndryshuar thelbësisht procesin e votimit, do të jetë thjesht letra dhe elektronika ajo që do të ndryshojë. Pra, zgjedhësit do të votojnë ele-

tronik, dhe vota nuk do të shkojë në një kuti votimi, por në një pajisje elektronike. Ne kemi rënë dakord që për 2019 të jetë një projekt pilot, në disa prej bashkive, dhe në zgjedhjet ardhshme parlamentare të implementohet në shkallë totale. Kjo ishte kërkesë e ndërkomëtarëve. Duhet të themi s'gjidhjet elektronike sot janë të mundshme, por na duhet të ecim me hapa të kujdesshme. Brenda korrikut parlamentari do të ketë hartuar rregullat e ashpër për garantimin e votimit elektronik", tha Bylykbashi.

Afati i fundit për aplikime deri në 15 korrik, dokumentet për të përfituar

Ornela Manjani

Sipërmarrësve dhe fermerëve u jepet sërish mundësia të aplikojnë për të përfituar financim në masën 50 për qind për investime në agroturizëm dhe bujtina. Ministria e Bujqësisë ka rihapur thirrjet për aplikime, duke reflektuar ndryshimet që janë bërë në këto masa së fundmi. Drejtoresha e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka bërë me dije se për agroturizmin janë vënë në dispozicion 122 milionë lekë dhe priten të shpallen fitues 12 aplikantë, ndërsa për bujtinat janë vënë në dispozicion 32 milionë lekë dhe është parashikuar të mbështeten 22 aplikantë. Synimi është mbështetja e projekteve që ruajnë identitetin e zonave dhe nxisin zhvillimin rural dhe agroturizmin. Të interesuarit duhet të dorëzojnë aplikimet përmes dosjeve fizike me dokumentacionin përkatës pranë AZHBR-së deri në datën 15 korrik 2018.

NJOFTIMI PËR APLIKIMIN

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka rihapur thirrjet për aplikime të Skemës Kombëtare për masat mbështetëse nr. 44, 45 në sektorin e agroturizmit dhe bujtinave. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 22 dhe Udhëzimin Nr.11 të firmosur nga ministrat Pelesh dhe Ahmetaj janë refle-

Financimi, rihapen aplikimet për agroturizmin dhe bujtinat

Buxheti financon 50 % të investimit

FINANCIMI
Drejtoresha e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka bërë me dije se për agroturizmin janë vënë në dispozicion 122 milionë lekë dhe priten të shpallen fitues 12 aplikantë, ndërsa për bujtinat janë vënë në dispozicion 32 milionë lekë dhe është parashikuar të mbështeten 22 aplikantë.



ktuar ndryshimet e mëposhtme: masa mbështetëse nr. 44 jep mbështetje për ngritjen apo rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural (bujtina) me kapacitet nga 4 deri 10 dhoma në 50 % të investimit me masë financimi deri në një milion e pesëqind mijë lekë. Masa mbështetëse nr. 45 jep mbështetje për ndërtim apo rikonstruksionin strukturash agroturistike deri në 50% të investimit me mase

financimi deri në dhjetë milionë lekë. "Nëpërmjet kësaj skeme është vënë në dispozicion një buxhet prej 122 milionë lekë për masën 45, ku parashikohen minimumi 12 aplikime fituese, të cilat do të rezultojnë në investime agroturizmi serioze në zonat rurale. Gjithashtu, një buxhet prej 32 milionë lekë është alokuar për masën 44, ku parashikohet ngritja ose rikonstruksioni i minimum 22 bujtinave.

Projektet fituese janë ato investime që kryejnë veprimtari mikpritëse, që zhvillohen në një fermë bujqësore apo në një veprimtari tjetër agrikulturore, me qëllim tërheqjen e vizitorit

ndaj cilësisë së prodhimeve dhe përpunimeve autentike të fermës, ushqimit, arkitekturës, dhe karakteristikat specifike të zonës. Përfituesit potencialë të kësaj skeme janë fermerë, persona fizikë

ose juridikë të cilët duhet të paraqesin pranë AZHBR, dosje fizike me dokumentacionin përkatës sipas udhëzimit nr. 11 dt. 21.6. 2018". Thuhet në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë.

PROJEKTET DUHET TË PËRFSHIJNË:

- Pjesën konstruktive, arkitekturore të shoqëruar me një relacion teknik nga arkitekti.
- Një plan biznesi të qenësishëm 5-vjeçar
- Të përmbushë standardet e akomodimit dhe mbrojtjes mjedisore si dhe sigurinë ushqimore
- Të ketë përmbushur detyrimet tatimore për personat fizikë dhe juridikë
- Ndërsa për aplikuesit fermerë të kenë shlyer sigurimet shoqërore

Aksioni në zonat turistike

Tatimet nisin verifikimet në 20 mijë biznese në të gjithë bregdetin

Pas paralajmërimit që u është bërë sipërmarrjeve në zonat turistike që të zbatojnë legjislacionin dhe të deklarojnë xhiron reale, strukturat e Zbatimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë nisur verifikimet në terren për të siguruar mbarëvajtjen e sezonit turistik. Kontrolltet filluan me disa subjekte në zonën e Gjirit të Lalzit, në Durrës, ndërsa bëhet e dije se do të vijohet në të gjitha zonat turistike të vendit ku do të verifikohen më shumë se 20,000 tatimpagues. Administrata tatimore ka si qëllim kontrollin dhe verifikimin e tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor, në mënyrë që të sigurohet respektimi detyrimeve ligjore, si: për të qenë të regjistruar si biznes në QKB dhe në administratën tatimore; për dokumentimin e mall-



rave gjendje apo në transport; për të lëshuar kupon tatimor apo faturë tatimore për çdo transaksion që tatimpaguesi kryen me klientët e tij; për të regjistruar të gjithë punonjësit e angazhuar në biznes me kohë të plotë apo të pjesshëm; për të afishuar çmimet e shitjes së mallrave apo të shërbimeve të ofruara. Drejtorja e Tatimeve bën me dije se nuk është qëllim ndëshkimi i

subjekteve, por edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, të përcaktuara nga legjislacioni, si dhe nxitjen për të realizuar në kohë pagesat. Administrata Tatimore është e angazhuar për të qenë në çdo kohë e pranshme në territor; për të kontrolluar dhe verifikuar nga afër situatën në të gjitha zonat turistike të vendit.

Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **2 Korrik 2018**, do të ofrojë pesë paketa të reja standarte me vlefshmëri **30 ditë** për pajtimtarët me parapagesë të planit tarifor Vodafone Club, të cilat do të zëvendësojnë paketat aktuale standarte, si më poshtë:

	Vodafone Talk	Vodafone Combo	Vodafone Z	Vodafone Silver	Vodafone Gold
Minuta Kombëtare	200	2,500	400	3,000	3,500
Minuta drejt rrjeteve fikse				10	60
Minuta ndërkombëtare					
Internet	200 MB	2 GB	5.5 GB	5.5 GB	12 GB
Përfitimë të tjera			10 GB Social & Chat		
SMS brenda rrjetit Vodafone	200	2,000	400	2,500	3,000
SMS kombëtare		200		300	400
SMS ndërkombëtare					
Vlefshmëria	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë
Cmimi (me TVSH)	800 Lekë	1200 Lekë	1500 Lekë	1500 Lekë	2200 Lekë

Paketat 30 ditore standarte Club Basic, Club Superior, Club GigaDepo, Club Extra dhe Club Elite nuk do të ofrohen më në treg.

Klientët me parapagesë, të cilët do të kenë aktive një nga paketat standarde në momentin e ndryshimit, do ta përdorin atë të pandryshuar deri në përfundimin e vlefshmërisë së saj.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.





Maskat grabitin pikën e transferimit të parave në Shëngjin, alarmi shpëton dy biznese të tjera

LEZHË - Një pikë e transferimit të parave në Shëngjin është grabitur në orët e para të mëngjesit të djeshëm nga disa persona të maskuar. Mësohet se pesë persona ende të pidentifikuar, me maska dhe leva kanë mundur të marrin një shumë prej rreth 5 milionë lekë të vjetra. Burime zyrtare nga policia e Lezhës

bënë me dije se ngjarja ndodhi rreth orës 03:00 në qendër të qytetit të Shëngjinit. Pavarësisht vjedhjes së kryer, hajdutët nuk janë larguar, por kanë tentuar të vjedhin dhe një exchange dhe një pikë shitjesh të lëndëve të ndërtimit, por janë ndaluar vetëm nga rënia e sinjalit të këtyre bizneseve. Pas sinjal-

izimit për grabitjen, forca të shumta policie kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikim dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Gjithashtu, blutë kanë ngritur postblloqe dhe kanë bërë krehjen e gjithë zonës, por pa mundur të bien në gjurmët e hajdutëve. Policia po analizon edhe disa kamera sigu-

rie për të parë nëse mund të bjerë në gjurmët e grabitësve, të cilët e kishin lënë mjetin e tyre në distancë për të mos u filmuar. Ndërkaq, banorët e Shëngjinit thanë se vjedhja të tilla nuk ndodhnin prej kohësh në qendër të qytetit dhe krahas sigurisë që ata do marrin vetë kërkohet që edhe Policia e Shëngjinit të jetë më e pranishme gjatë natës me kontrollet e tyre dhe jo të fokusohet vetëm tek trafiku.

Investimi, 111 mln euro për qendrat pilot të trashëgimisë kulturore dhe agrobiznesin

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Ndotja e alpeve shqiptare është kthyer në shqetësim për BE-në që investon nëpërmjet programeve të ndryshme për zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Dje, në hapjen e sezonit turistik në Razëm të Malësisë së Madhe, përfaqësuesja e BE-së, Annelies Vanwymelbeke, kritikoi dhe tërhoqi vëmendjen në lidhje me hedhjen e mbeturinave në alpe. Gjatë aktivitetit ajo tha se mjedisi duhet ruajtur dhe për këtë duhet që të aktivizohen të gjithë si e vetmja mënyrë për zhvillimin e turizmit dhe rritjen e numrit të turistëve. Sipas Vanwymelbeke, shqetësim për komunitetin evropian janë edhe problemet në çështjet e pronësisë, të cilat nuk lejojnë ashtu si duhet zhvillimin e zonave turistike. "Në zona si Razma natyrisht që zhvillimi i turizmit duhet të ketë parasysh edhe ruajtjen dhe promovimin e traditës që ka të bëjë edhe me pasuritë natyrore. Në Alpet evropiane ka kërkesa të forta për kontrollin e ndotjeve dhe gjithë elementëve të tjerë. Këto standarde duhet të mbahen parasysh edhe në ofertat turistike këtu. Zhvillimi i turizmit në Alpet shqiptare ende po has vështirësi në mungesën e kuadrit rregullator të qartë apo problemit të mbrojtjes së mjedisit dhe mos hedhjes së mbeturinave për sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm. Duhet të bëni kujdes më të madh duke kontrolluar hedhjen e mbeturinave dhe përfshirjen e qytetarëve për mbrojtjen e Alpeve shqiptare. Ekoturizmi ju ndihmon për zhvillimin lokal. Alpet shqiptare kanë shumë për të ofruar, por shumë edhe për të përfutuar", u shpreh përfaqësuesja e BE-së. Ndërkaq, ajo deklaroi se është shumë e rëndësishme promovimi dhe ruajtja e cilësisë së ushqimeve dhe produkteve lokale që kemi, pasi ato janë një potencial shumë i madh që duhet të promovohen dhe të shihen si një mundësi në drejtim të zhvillimit

Çelet sezoni turistik në Razëm, përfaqësuesja e BE: Stop ndotjes së Alpeve nga mbeturinat

"Të zgjidhet problemi i pronësisë, pengon zhvillimin e zonave turistike"



Përfaqësuesja e BE-së, Annelies Vanwymelbeke,



Çelja e sezonit turistik në Razëm,

40

MLN EURO

Përfaqësuesja e delegacionit të BE-së tregoi edhe për mbështetjen financiare që po jep Bashkimi Evropian nëpërmjet programit "Turizmi si model udhëheqës për Zhvillimin Ekonomik Lokal". Ajo tha se është një fond prej 40 milionë euro për zhvillimin e ekonomisë lokale për turizmin e qëndrueshëm dhe ndaj kërkesave të turistëve.

71

MLN EURO

Zyrtarja e BE-së, Annelies Vanwymelbeke pohoi, gjithashtu, se përmes programit IPARD do të ketë mbështetje të agrobiznesit shqiptar dhe ky fond është rreth 71 milionë euro dhe do t'iu sigurojë fermerëve shqiptarë dhe agrobiznesit që të përmirësojnë aktivitetin e tyre.

ekonomik, por nëpërmjet aktiviteteve të turizmit. "Europa po i jep rëndësi produkteve bujqësore që kanë vullën e origjinës", tha Annelies Vanwymelbeke. Sipas saj, tendenca e sektorit ushqimor është për produktet lokale duke u dhënë rëndësi produkteve autentike dhe speciale. "Kam dëgjuar që hudhra në Razëm ka shije të veçantë apo kërpudhat e Reçit kanë kërkesë për t'u dërguar në Francë. Po ashtu kam dëgjuar edhe për cilësinë e gështenave. BE kërkon sot që të ketë një zgjidhje të problemeve të pronësisë në zonat turistike të Shqipërisë apo problemit

të diversifikimit të ofertës turistike apo mungesës së duhur në treg për t'iu përshtatur nevojave turistike", u shpreh Vanwymelbeke. **INVESTIMET E BE** Përfaqësuesja e delegacionit të BE-së tregoi edhe për mbështetjen financiare që po jep Bashkimi Evropian nëpërmjet programit "Turizmi si model udhëheqës për Zhvillimin Ekonomik Lokal". Është një fond prej 40 milionë euro për zhvillimin e ekonomisë lokale për turizmin e qëndrueshëm dhe ndaj kërkesave të turistëve. Është e ndarë në dy programe dhe programi i parë do testojë turizmin si sektor

udhëheqës duke u fokusuar në disa qendra pilot të trashëgimisë kulturore duke përzgjedhur Beratin, Fierin, Korçën dhe Shkodrën. Komponenti i dytë do jetë në këto zona dhe do bazohet kryesisht në nevojat e tyre dhe potencialet që ato kanë për zhvillimin lokal. Bashkitë do marrin suport nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës që është në shërbim të bizneseve. Do ketë përmirësim të efikasitetit të energjisë dhe mbrojtjen e ndryshimeve klimatike. Po ashtu në partneritet me bankën evropiane për rindërtim, BE do të lançojë së shpejti programin

për mbështetjen dhe rehabilitimin e qendrave të trashëgimisë kulturore më të rëndësishme të vendit duke mundësuar që ato të kthehen në zona që mund të ofrojnë një paketë turistike më të gjatë si dhe dhënie e granteve për zgjerim të kapaciteteve të bizneseve, deklaroi Vanwymelbeke. Ndërkaq, ajo pohoi se përmes programit IPARD do të ketë mbështetje të agrobiznesit shqiptar dhe ky fond është rreth 71 milionë euro dhe do të sigurojë fermerëve shqiptarë dhe agrobiznesit që të përmirësojnë aktivitetin e tyre.

SHKURT

Vjedhin "Benz"-in në Tiranë, autorët "luftë" me policinë në Bulqizë

BULQIZË - Dy persona ende të pidentifikuar kanë vjedhur një automjet tip "Benz" në Tiranë, ndërsa kanë udhëtuar me të drejtë Bulqizës. Menjëherë policia e Tiranës ka njoftuar atë të Dibrës në lidhje me ngjarjen. Pas sinjalizimit, blutë e Dibrës kanë ka ngritur menjëherë pikë kontrolli për ndalimin e mjetit, por nuk ia kanë dalë, pasi autorët janë larguar me shpejtësi, duke rrezikuar dhe jetën e efektivëve. Mësohet se blutë kanë qëlluar në ajër, por autorët kanë braktisur mjetin dhe ia kanë mbythur në këmbë. Ndërkaq, policia është në ndjekje të tyre.

Dogji urën që lidh banorët e 2 fshatrave, ndalohe 47-vjeçari

FIER - Policia e Fierit ka ndaluar një 47-vjeçar, pasi teksa digjte mbeturinat në tokën e tij, aksidentalisht ka djegur edhe një urë që lidhte dy fshatra. Ngjarja ka ndodhur në Kallm, ndërsa mësohet se ura që kalonte mbi lumin Seman lidhte fshatin Belinë me Kallmin. Si pasojë e djegies së urës kanë mbetur të izoluar banorët e dy fshatrave në fjalë. Burime zyrtare nga policia pohuan se Mentor Hatia akuzohet për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

Aksidentet rrugore në Tiranë, Kavajë, Elbasan dhe Mallakastër

Përgjaket fundjava, vdes 12-vjeçarja dhe plagosen 10 të tjerë

Një 12-vjeçare ka humbur jetën dhe 10 persona të tjerë janë plagosur në tre aksidente automobilistike të ndodhura dje në rrethe të ndryshme të vendit. Aksidenti i parë ku u përfaqshin tre automjete ka ndodhur rreth orës 06:40 në aksin Rinas-Kashar (në afërsi të urës së Tiranës) ku për pasojë 6 persona mbetën të plagosur. Sipas burimeve policore, në këtë aksident u plagosën shtetasit: S.B., 29 vjeç; A.B., 28 vjeç; O.M., 23 vjeç; R.M., 22 vjeç; G.V., 22 vjeç dhe R.H., 51 vjeç. Mësohet se 23-vjeçarja ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa të plagosurit e tjerë janë jashtë rrezikut për jetën. Pas këtij aksidenti, dëshmitarë në ngjarjes janë shprehur se kanë parë tmer me sy. "Dy makina janë ndarë në dysh. Isha në momentin që u bë aksidenti kam pa tmer me sy. Për 15 minuta nuk erdhi ambulancë,



Aksidenti në Kavajë



Aksidenti në Rinas

ca, u vonua shumë", tha njëri prej tyre. Aksidenti i dytë u shënuar rreth orës 11:30 te mbikalimi i Kavajës. Sipas bluve mjeti me targë AA396HJ, me drejtues shtetasen M.J. (është shoqëruar) ka aksidentuar 12-vjeçaren SH.T., e cila ndërroi jetë në spitalin e Durësit. Aksidenti i tretë u shënuar në aksin rrugor

Ballsh-Fratar, ku një kamion është përplasur me një makinë dhe për pasojë 3 persona kanë mbetur të lënduar. Ngjarja ndodhi në vendin e quajtur "Greshicë". Policia e Fierit bëri me dije se Urim Koliqi, duke drejtuar automjetin tip kamion është përplasur me mjetin tip "Wolkswagen" me drejtues shtetasin Sh.P. 49 vjeç. Si pa-

sojë e përplasjes janë dëmtuar pasagjerët e mjetit tip "Wolkswagen" shtetaset F.D, 55 vjeçe, E.D. 54 vjeçe dhe shtetasi A.D. 60 vjeç, banues në Mallakastër, të cilët ndodhen në Spitalin Rajonal Fier nën kujdesin e mjekëve. Ndërsa, në aksin Elbasan-Metalurgji janë përplasur dy makina dhe për pasojë është plagosur drejtuesi i njërit mjet.

SHKURT

Ndahet nga jeta shkrimtari dhe dramaturgu Loni Papa

Me datë 22 Qershor 2018, në Montreal, Kanada u nda nga jeta, në moshën 86-vjeçare, shkrimtari Loni Papa. Loni Papa ka lëvruar në gjininë e dramaturgjisë, prozës, poezisë dhe letërsisë për fëmijë. Vepra e tij më e njohur është drama "Cuca e Maleve". Për kontributin e tij në letërsinë shqipe, është vlerësuar me Çmimin e Republikës, disa çmime kombëtare dhe mban titullin "Qytetar Nderi" i qytetit të tij të lindjes, Lushnje. Ceremonia e lamtumirës do të bëhet në Tiranë, ditët e ardhshme.

Kapet i kërkuari për shfrytëzim prostitucioni në Itali

TIRANË - Një 47-vjeçar nga Tirana ka përfunduar në pranga, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga drejtësia italiane për veprimet e "Organizatë kriminale me qëllim shfrytëzimin e prostitucioni". Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin Marko Hidri, i cili është dënua nga gjykata e vendit fqinj me 4 vjet e 6 muaj burg. Ndërkaq, Zyra e Interpol Tirana po kryen veprimet e mëtejshme për ekstradimin e këtij shtetasi drejt Italisë.

Arrestohet shqiptari i arratisur nga burgu grek

GREQI - Një nga tre shqiptarët e arratisur pak ditë më parë nga burgu është arrestuar dje nga policia greke. Bëhet fjalë për 24-vjeçarin Gertian Vrushaj, ndërkohë që janë në kërkim dhe dy shqiptarë të tjerë; Marjus Dedolli, 31 vjeç si dhe një 17-vjeçar. Operacioni për arrestimin e tyre po zhvillohet në zonën e Luca-Koropi të Atikës në rajonin e Athinës. Të rinjtë akuzohen për një sërë vjedhjesh. Të arrestuarit ishin pjesë e bandës me 5 veta që u kapën në 13 qershor me akuzën e 72 vjedhjeve në zonën e Atikës me një vlerë mbi 400 mijë euro.

Festonte fitoren e Zvicrës, theret me thikë shqiptari

ZVICËR - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Bazel të Zvicrës, ku një shqiptar ka mbetur i plagosur me thikë. Ngjarja është shënuar pas festimeve për fitoren e Zvicrës përballë Serbisë, ku dy shqiptarët Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka bënë dy gola. Mësohet se shqiptari, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije, është qëlluar me thikë në këmbë nga disa persona. Por agresorët nuk janë mjaftuar me kaq, pasi ia kanë grisur edhe flamurin shqiptar. Fill pas ngjarjes i riu është dërguar në spital, ndërsa fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NË KOHË REALE LAJMET E FUNDIT NË APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET KËRKONI NË APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

WORLD BANK OFFICE, Tirana

VACANCY ANNOUNCEMENT

The World Bank Office in Tirana is seeking to employ a local Short-Term Temporary (STT) experienced Program Assistant. The incumbent is expected to perform in a demanding institution, with high professional standards. The World Bank is an important development partner of Albania, finances an extensive assistance program, and carries an active policy dialogue with the Government and other development partners.

Skills Required:

- A university degree or equivalent education.
- Demonstrated verbal and written communication skills, including the ability to communicate in Albanian. Excellent knowledge of written and spoken English is essential. Translation and interpretation skills would be a definite asset.
- Preference would be given to candidates with demonstrated experience as program assistants with a minimum of 2 years.
- Strong computer skills; proven ability to use standard and customized technology packages, e.g., Internet, Word, PowerPoint, Excel. Familiarity with Outlook Mail is preferable.
- Knowledge and understanding of information management, procedures and best practices, including the relevant technology and system knowledge.
- Familiarity with communications approaches, tools, and methodologies.
- Strong organizational, research/analytical and presentation skills.
- Knowledge of social, political and development issues in Albania to work closely with Sr. Communications Officer to make the service available on-line through the World Bank Country Office Website and Facebook.
- Teamwork/Collaboration skills and recognized ability to work effectively in a team-oriented environment.
- Outstanding verbal communication and interpersonal skills to interact effectively with a range of contacts internally and externally using maturity, good judgment, tact and diplomacy.
- Demonstrated skills in organizing, prioritizing, scheduling, planning and coordinating work and other activities internally and externally.
- Ability to take personal ownership and accountability to meet deadlines.

Terms and Conditions of Employment:

The position will be a short-term contract (up to 12 months). This position could be later converted into a longer-term contract provided the incumbent demonstrates satisfactory performance, and if an opening becomes available. Fees and benefits are highly competitive. The World Bank offers its permanent staff extensive opportunities for training and career development.

Applications shall include:

- A cover letter in English, documenting the applicant's skills and qualifications for this position.
- A copy of the University Diploma or other equivalent studies.
- A detailed Curriculum Vitae with the names and addresses of previous employers and a description of duties and responsibilities.
- The name, address and contact telephone number of at least two professional references from previous employers or teachers/professors (for recently graduated candidates).

All applications, including supporting documents, should be authentic and submitted to World Bank Office in a sealed envelope addressed to the Country Manager, no later than close of business July 6, 2018. Please note only short-listed candidates will receive responses within fourteen days of the job posting closing date.

Address
World Bank Office
"Ibrahim Rugova" Street, No. 34
Tirana, Albania
Tel: +355 (0) 42 280 650/51

Dozjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtitimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesës, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtitimit të Pronave është detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përkrahur në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencinë'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
987	KORÇE	SOTIR		PERMETI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
988	KORÇE	RAMADAN		CEZMA		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
989	KORÇE	GURALI		METELAI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
990	KORÇE	AGEN		METALLA		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
991	KORÇE	EQEREM		KAPI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
992	KORÇE	VANGJUSH		MALEVECI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
993	KORÇE	RESMIE		BIXHOKU		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
995	KORÇE	LURIKA		NAKO		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
996	KORÇE	ETHEM		RUSTEMI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
977	KORÇE	NISI		SOVANI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
998	KORÇE	DAJET		ISMAILI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
999	KORÇE	FERDINAND		RISA		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1000	KORÇE	REFIK		CEZMA		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
1001	KORÇE	FESTIM		BONA		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
1002	KORÇE	LLAMBI		FOTO		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
1003	KORÇE	ILIA		SHESHMINI		JANE PAISUR ME AKT-PERDORIMI SI PUNONJES NB NE BAZE TE DEKRETI 1431, DT. 27.03.1996/NUK KA DOKUMENTA PRONESIE NE DOSJE
52	POGRADEC				91500 IM2	
52	POGRADEC	BLERIM		CELA	SHFUQIZIM I V. 690, DT. 29.09.2009	
	POGRADEC	BLERIM		CELA	SHFUQIZIM I V. 368, DT. 05.02.2008	
566	POGRADEC	DRITAN		MANKOLLARI		
418	POGRADEC	SOFIKA		TENEQEXHI	23600 M2	Vendimi nuk ka marre forme te prere
	POGRADEC	SOFIKA		TENEQEXHI	11000 IM2	
593	POGRADEC	VLADIMIR		KAVAJA		
336	ERSEKE	KOZETA		SHYTI	339.5 HA MOSNJOHJE 200.5 HA	
	ERSEKE	KOZETA		SHYTI	RREZIM KERKESJE	Vendimi nuk ka marre forme te prere
348	POGRADEC	SHPRESA	GAQI	SAMI	3000 M2	
	POGRADEC	SHPRESA	GAQI	SAMI	SHFUQIZIM I V. 940, DT. 27.04.2009	
583	KORÇE	ARBEN		BERBERI	872 M2 MOSNJOHJE 588 M2	
	KORÇE	ARBEN		BERBERI	2028.8 M2	
795	KORÇE	SHKENDUJE		PALENA	24 HA	
	KORÇE	SHKENDUJE		PALENA		
778 (296)	DEVOLL	FATIME		KARLUNI	75000 M2	
	DEVOLL	VULNET		SPANO		
728 (239)	DEVOLL	ORHAM	SYRIA	POJANI	500 HA	
	KORÇE	ENVER		BEIKO	6084 M2	
447	KORÇE	HEKURAN		YZELLARI		
86	KORÇE	OLSI		MANOSUPI		
267	DEVOLL	MUHARREM	NAZI	MULLA	26500 M2	VENDIMI FOTOKOPIJE DHE NUK KA MARRË FORMË TË PRERË
267	KORÇE	HASANI		DUMBROVA	MOSNJOHJE PRONESIE	
52	BILISHT	DASHAMIR		LLZHURI		
	BILISHT					
497	BILISHT				3865 M2	Vendimi nuk ka marre forme te prere
1182	POGRADEC				MOSNJOHJE 214000 M2	
7	POGRADEC				252 M2	
368 (353)	POGRADEC	MYRSEL		MALELLARI	6879 M2	
555	POGRADEC					PA VENDIM
546	POGRADEC	NEUZAT		TORELLI		
557	POGRADEC	KUTITIM		BOCI		
559	POGRADEC	GIJERGJI		ILO		
561	POGRADEC					



Personazhe të njohura të artit, medias e biznesit në eventin mbresëlënës

Veshje të bardha e shampanjë franceze, VIP-at dehen në “Prestige Resort”

Sipërmarrësit Fabiola dhe Oni Hysenbelliu mikpresin të ftuarit




Një event mbresëlënës i organizuar buzë detit në Durrës, ka bërë bashkë personazhe të njohura të botës së medias, artit e biznesit në vend. Të veshur në të bardha, në një ambient të arreaduar në mënyrë mbresëlënëse ku dominonte po ngjyra e bardhë, të pranishmit kanë shijuar brunch-in special nga “Moët & Chandon Ice Imperial”.

Pikërisht për këtë ishte organizuar edhe eventi i Landmark Communications në resortin “Prestige”, ku të ftuarit shijuan të parët gotat e shampanjës elitare.

Një menu speciale me bazë deti dhe frutash ekzotike realizuar me mjeshtëri nga Chef i “Prestige Resort” shoqëroi shijen fine dhe delikate të shampanjës.

Ky event që zhvillohet në të gjithë botën është risi nga Eurolab Internacional Grup, që bën bashkë shijen ekselente të “Moët & Chandon Ice Imperial” me njohësit e mirë të shampanjave në Shqipëri, personazhet më të spikatur të jetës publike.

Sipërmarrësit motër e vëlla, Fabiola dhe Oni Hysenbelliu, Jonida Maliqi dhe motra e saj Xhilda, Algen Nikolla, Vera Grabocka, Klodiana Shala, Olta Gixhari, Fjodora Fjora, e të tjerë personazhe kaluan një fundjavë të paharrueshme.



Ministri i Brendshëm dhe drejtori i Policisë së Shtetit: Bashkëpunim i shkëlqyer

Khafaj-Veliu në Berlin, takim me krerët e policisë gjermane

Bashkëpunim për menaxhimin e flukseve emigratore

Gjatë vizitës në Berlin, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu u pritën nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë Federale, zoti Dieter Romann.

Duke vlerësuar nivelin e shkëlqyer të bashkëpunimit me policinë shqiptare, Romann, u shpreh se "jam i nderuar dhe shumë i lumtur për këtë mundësi për t'u takuar dhe për të biseduar rreth temave të përbashkëta".

Ministri Xhafaj theksoi se qëllimi i vizitës është konsolidimi më tej i marrëdhënieve të deritanishme, për t'i bërë model në rajon. Në këtë kontekst, Xhafaj u shpreh se asistenca dhe përvoja e Gjermanisë është shumë e rëndësishme, veçanërisht nga këndvështrimi strategjik, në kushtet e procesit të reformimit të policisë.

Në vijim, ata u ndalën tek situata aktuale lidhur me migracionin e paligjshëm dhe problemet me të cilat po përballon Policia e Shtetit në menaxhimin e kësaj situatë. Për këtë çështje, shtoi ministri Xhafaj, kam diskutuar edhe me Komisionerin e BE-së, Avramopoulos dhe kam kërkuar mbështetje financiare dhe logjistike nga Brukseli.

Duke marrë në konsideratë origjinën e flukseve migratore dhe rrugën që ndiqet për të depërtuar në vendet e BE-së, palët ndanë të njëjtin mendim se bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor në menaxhimin e këtyre flukseve.

Për Gjermaninë, u shpreh Romann, përballimi i situatës që lidhet me migracionin është detyrë parësore e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë Federale, kjo edhe e lidhur me mungesën e informacionit nga vendet e origjinës, vështirësisë në identifikimin e individëve, apo problematika të sigurisë që shoqërojnë këtë fenomen.

Lidhur me këtë çështje drejtori Ardi Veliu u ndal te masat që ka ndërmarrë Policia e Shtetit, veçanërisht ajo Kufitare për një menaxhim sa më të mirë të regjimit të kufirit. Ai u ndal po ashtu, edhe në mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të nevojshme për përballimin e situatave të tilla. Veliu falënderoi Policinë Federale



Fatmir Xhafaj dhe Ardi Veliu me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Federale, zotin Dieter Romann.

për ndihmën që i ka ofruar Policisë së Shtetit. Romann u shpreh se ishte shumë i impresionuar nga arritjet dhe bashkëpunimi me Policinë e Shtetit. Ai pranoi me shumë entuziazëm ftesën e Ministrisë Xhafaj për të vizituar Ti-

ranën. Një tjetër takim u zhvillua ne Policinë Kriminale Federale, midis drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Ardi Veliu, shoqëruar nga drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale Eduart Merxaj dhe drej-

torit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Arsimimit dhe Kërkimit Shkencor ne BKA, Gerhard Hantschke. Hantschke tha se bashkëpunimi aktual është në nivele të larta. Ata ranë dakord mbi rritjen e këtij bashkëpunimi, si në fushën e

DREJTORI I POLICISË

Ardi Veliu u ndal te masat që ka ndërmarrë Policia e Shtetit, veçanërisht ajo kufitare për një menaxhim sa më të mirë të regjimit të kufirit. Ai u ndal po ashtu, edhe në mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të nevojshme për përballimin e situatave të tilla.

krimin të organizuar, krimet të drogës, trafikimit të personave, vjedhjeve të banesave etj. Zyrtari i policisë gjermane

përmendi në mënyrë të veçantë bashkëpunimin në kuadër të Task Forcës "Anti Skifter" si dhe "Forca e Ligjit". Drejtori Veliu e njohu bashkëbiseduesin me prioritetet e Policisë së Shtetit, si: lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, operacionin "Forca e Ligjit". Veliu theksoi se për një nga grupet e goditura është bashkëpunuar ngushtësisht me BKA gjermane.

Takimet u zhvilluan në një frymë të hapur dhe shumë miqësore. Bashkëbiseduesit ndanë mendimin se ky bashkëpunim i shkëlqyer sot mes dy vendeve, do t'iu shërbejë edhe brezave nesër.

Kryeministri i Hungarisë njihet si kundërshtar i paepur i hapjes së kufijve

Viktor Orban akuzon BE për kaos rreth çështjes së emigrantëve



Viktor Orban pohoi se për temën e emigrantëve duhet përgjegjësi dhe kjo nuk nënkupton liri për të gjithë për të hyrë në Europë. Ai theksoi se Hungaria nuk do të shkatërron kulturën dhe sigurinë e saj publike.

Kryeministri hungarez shtoi se deri sa Europa të mos adoptojë të gjithë emigrantët, katër vendet e Vishegrad nuk do të pranojnë asnjë më shumë. Amendamenti kushtetues i miratuar disa ditë më parë

dhe që bëri të jashtëligjshëm pranimin e emigrantëve në vend, si dhe ndjekje penale për ata që ndihmojnë emigrantët, u cilësua nga Orban si një punë e rafinuar ligjore.

Ai tha se këto vendime ishin propozuar dhe më parë nga partitë gjatë fushatave elektorale. Duke folur për sigurinë kombëtare kreu i ekzekutivit hungarez tha se nuk do të pranojë që organizatat e huaja të influencojnë çështjet e brendshme.

Sipas Orban janë tri çështjet kryesore për sa i përket migracionit në Europë. Një nga këto është mbrojtja e kufirit, dhe më pas gjetja e një zgjidhjeje për ata emigrantë që tashmë ndodhen në vend. Dhe e treta të bëhet e qartë se kush do të lejohet të hyjë

në Hungari në të ardhmen. Por kryeministri hungarez kritikoi dhe Europën duke thënë se ka një kaos institucional Brenda Bashkimit Europian dhe rendi kushtetues tashmë është një rrëmujë që ka nevojë për restaurim.

Sipas tij muajt e fundit grupi i Vishegrad i themeluar në 15 shkurt 1991 po punon gjithnjë e më shumë në këtë drejtim. Në fund të intervistës së tij ai komentoi dhe fitoren e Kroacisë ndaj Argentinës në kuadër të kampionatit botëror të futbollit në Rusi.

Ai tha se skuadra balkanike mund të ketë shpresa për të fituar kampionatin dhe kjo është një gjë e madhe. "Forca kroate", përfundoi ai.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 28.06.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbërimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasni", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Sipas ankandit e dytë për pasurinë e palajshme të debitorit Muharrem Hysen Greca:

-Banesa dykateshe, me sipërfaqe totale 333.16 m², e ndodhur në zonën kadastrale 8190, Vëllëdëklaruar pranë ALUDIN Tiranë Jug me nr. 428 datë 28.08.2006, adresë: Rr. "Vëllezërit Konrad", Tiranë. Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 4 790 083 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbërimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasni, Zyrë 107, Tiranë.

Njofim për shitje ankand II

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e Hipotekuesit A Milis. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- "Apartamenti" me numur pasurie 1/12611 - 4 Zonë Kadastrale 8170 Volumi 1, Faqe 154, me sipërfaqe 75.1 m², në adresën Rr "Q. Satafi" pall 8, shk 1, katë dyte , Ap 4 Tiranë
- Ankandi i pasurisë: fillon me çmimin me të ulët në masën 30 përqind të ankandit të parë.

Ankandi do të zhvillohet 13.07.2018 në orën 15:00 në sallinë Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, Zyrë nr. 5. Kontakti tel: 672082543 e-maili: ilir_dervishi@yahoo.com si dhe [WEB: www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com).

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbërimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofim se me datë 03.07.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i per shitiien e pasurise te paluajshme Trruall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtesa me sipërfaqe 128 m², regjistruar në Z.V.R.F.P Durrës me Nr pasurie 7267, Vol 3, Fa.199, Zk.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankand 128,640 (Njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 067207580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Gjermania përmbys Suedinë

Kampionët e botës tregojnë dhëmbët

Gjermania bën një re gjatim prej kampionëve bote. Skuadra e Lëvit pëson pambarimisht në pjesën e parë, por rilind në fraksionin e dytë duke marrë një fitore me vlera të jashtëzakonshme dhe që e rikthen kualifikimin në dorë të tyre. "Fisht Stadium" do të kthehet në arenën e një beteje nga ato që do mbahen mend gjatë. Gjermania e nis ndeshjen më mirë dhe krijon rastin e parë për shënim, por Draxler gjen

një rival mes tij dhe golit. Suedia përgjigjet me Berg, por Nojer shpëton kampionët e botës. Gjermania përpiket, por vuan në krijimin e hapësirave ndërsa Suedia është kërcënuese me kundërsulmin. Klaeson lëshon Toivonenin në zonën e Nojerit dhe suedezi e mposht gardianin e Bajernit me një lob shumë të bukur. Gjermania kërkon të reagojë, por e bën vakët, ndërsa Suedia i shkon fare pranë dyfishimit në shtesën e pjesës së parë, kur Berg dety-

ron Nojerin të bëjë një pritje prej fenomeni. Gjermania vuajti shumë në pjesën e parë, por në të dytën ndryshon mentalitet. E nis në sulm dhe barazon shumë shpejt. Minuta e 49-të dhe Rojsh arrin të gjuajë në zonë duke mposhtur Olsenin për

barazimin 1-1. Më pas ndeshja futet në një drejtim. Gjermania sulmon dhe Suedia është mbledhur në prapavijë. Rojsh do të provojë të gjejë barazimin duke tentuar të devijojnë me thembër harkimin e Kimish, por nuk do t'ia arrijë, ndërsa Vernen

shpërdoron në mënyrë të pabesueshme golin e avantzhit. Në fundin e takimit dramaticiteti i ndeshjes do të rritet ndjeshëm. Boateng del me karton të kuq dhe Lëv turfullon në stol. Duket sikur do të mbyllet në barazim sidomos pas predhës së

Brandt që gati sa nuk thyen shtyllën në fund, por në fund fitoi afORIZMA e Geri Linekerit: futbollit është një lojë me një top dhe 22 burra dhe në fund fiton Gjermania. Sepse kampionët e botës do ta mposhtin Suedinë me perllën e Toni Krostit, që sajoi hapësirën e duhur në murin dysh suedez për të thyer Olsenin e për të siguruar fitoren e parë, fitore që i mban gjallë shpresat e kualifikimit në ndeshjen e fundit ndaj Koresë së Jugut.

Presidenti i Serbisë flet pas veprimt "provokues" të Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit



Jeton Selimi

Gjesti i shqiptonjës, Vuçiç reagon: Ne nuk provokojmë askënd!

Krimineli Sheshelj tërbohët me Xhakën

Në Serbi nuk ka dhembur aq shumë humbja ndaj Zvicrës sesa festa e shqiptarëve që përfaqësojnë kryqtarët helvetë në ekipin Kombëtar. Pas golave, erdhi festa me gjestin e shqiptonjës, një përshëndetje e djemve për rrënjët e tyre shqiptare, e cila në Beograd është përjetuar si "provokacija" e radhës, me mediat serbe që arritën deri aty sa t'i kërkojnë FIFA-s ndëshkimin e lojtarëve, me qeverinë e Zyrës që po e mendon realisht ndëshkimin. Trondija në Serbi ka qenë e madhe, aq sa ditën e sotme ka reaguar vetë presidenti Aleksandër Vuçiç, që nga zyra e presidencës ka dhënë një mesazh për popullin e tij, duke kërkuar të minimizojë hidhërimin e një nate më parë. "Jam krenar për popullin tonë, jemi të trishtuar, por nuk kemi ofenduar askënd! Le të na urrejnë, por kombi ynë është i bashkuar, i bashkuar në trishtim, por



nuk fym asnjëri. U trishtuam, sepse e duam vendin tonë dhe jo, sepse e urrejmë



Ugly albanian bastard

dikë, ne do të mbështesim lojtarët tanë, ne besojmë në fitore në ndeshjen e ardh-

hme. Dhe nëse nuk fitojmë, do të vazhdojmë ta duam. Nëse urrejnë, kjo tregon për

madhësinë tonë". Por politika serbe nuk ka qëndruar kaq brenda korizave. Vojislav Sheshelj, lideri dhe themeluesi i partisë radikale SRS, një nga frymëzuesit e luftën çetnike në Kosovë, ka reaguar publikisht ndaj gjestit të Granit Xhakës. Sheshelj ka publikuar në Twitter: "Bastard i shëmtuar shqiptar" shkruan Sheshelj, shoqëruar me Xhakën në momentin që bën me duar "shqiptonjën". Katër muskëterët me gjak kuqezi, Xhaka, Behrami, Xhemajli e Shaqiri, kanë dhuruar një performancë për t'u vënë në kornizë kundër Serbisë, teksa kanë arritur të fitojnë me përbysje në ndeshjen e dytë të

grupit E. Madje, si për ta ndezur edhe më këtë sukses, autorët e fitores së madhe të Zvicrës janë Granit Xhaka e Xherdan Shaqiri, që me golat e tyre përmbysën epërsinë e përkohshme serbe të arritur me rrjetën e Aleksandër Mitrovic. "Ka qenë vetëm emocion. Jam i lumtur për golin dhe asgjë më shumë. Nuk besoj se duhet të flasim për gjë tjetër, ka thënë Shaqiri, ndërsa Granit Xhaka ka shtuar: "Të jem i singertë nuk më interesonte kundërshtari. Festa ishte për popullin tim që më ka mbështetur gjithnjë, për vendlindjen time, për prindërit e mi".

Hazar dhe Lukaku shënojnë nga dy gola

Gola dhe spektakël, Belgjika thyen Tunizinë

Belgjika realizon një mania dhe siguron matematikisht kalimin për në 1/8-at e Kupës së Botës. Skuadra e Roberto Martinez ka ngadhënjyer kundër Tunizisë në ndeshjen që ka prodhuar më shumë gola në këtë botëror për një rezultat të përgjithshëm 5-2. Kryesori Marrufo akordon 11-metërsh dhe e konfirmon vendimin pas konsultimit me VAR-in. Nga pika e bardhë ekzekuton po vetë Hazar, që tund rrjetën. Belgjika në avantazh dhe Belgjika, me golin e dytë që vjen pak minuta më vonë kur Mertens jep një

asist të ëmbël për Lukakun, i cili në diagonal thyen Ben Mustafan. 2-0 dhe duket se ndeshja arkivohet shumë shpejt, por nuk mendon kështu Tunizia, që pa kaluar as 2 minuta shkorton diferencat me Dylan Bron, që me kokë mposht Kurtuan. Në kohën shtesë të pjesës së parë Lukaku ka dy raste shënimi, ku të parën nuk arrin të devijojë në portë, ndërsa të dytën nuk e fal, duke i çuar skuadrat me rezultatin 3-1 në pushimin e ndeshjes. Por belgët janë të uritur dhe e nisën pjesën e dytë ashtu siç mbyllën të parën. Belgjika shënon që në 51-ën me Hazar, që shërbehet mjaft

mirë nga Alderveireld dhe realizon pasi shmang edhe portierin. Batshuajti realizon kur gjuan fluturimthi me të majtën brenda zonës dhe shënon golin e pestë për Belgjikën dhe të parin për të në një Kupë Bote. Gjithsesi, Tunizia do të reagojë me krenari dhe do të realizojë golin e dytë të saj, kur Kazri gjuan saktë në këndin e poshtëm të portës për të thyer Tibo Kurtuan. Mbyllet 5-2 në stadiumin e Spartakut të Moskës, Belgjika vijon më tej, ndërsa Tunizia praktikisht është eliminuar, ndonëse ka dhe një ndeshje për të zhvilluar

Ekipi i gjashtë që kalon në 1/8-a

Meksika fitore dhe kualifikim ndaj Koresë

Meksika është e kualifikuara e gjashtë e kualifikuar për në fazën e 1/8-ave të Kupës së botës pas fitores në takimin e sotëm ndaj Koresë, ndeshje në të cilën triumfoi me shifrat 2-1. Ndeshja do të nisë me Korenë më të orientuar drejt sulmit, ndërsa Son do të ketë mundësinë më të mirë për aziatikët për të shënuar, përpara se Meksika të fitojë penalltinë që zhblloko ndeshjen. Në minutën e 24-të Guardado krosn nga e majta dhe Jang Hjun So ndërpret harkimin me dorë. Për serbin Maziç nuk ka dy-



shime, 11-metërsh të cilin e kthen në gol Karlos Vela. Pjesa e dytë do të nisë vrullshëm nga Meksika, dukshëm në kërkim të golit të dytë për të mbyllur hesapet e kualifikimit. Madje do ta arrijë në minutën e 66-të Lozano nis një kundërsulm të rrufeshëm që finalizohet me gol nga ana

e Çiçaritos, që gjuan saktë në shtyllën e parë. Minuta e 93-të dhe Son Heung-Min lëshon një gjuajtje plot efekt nga jashtë zonës, që mposht Oçuan e prehet në rrjetë. 2-1, por fatkeqësisht nuk ka më kohë për koreanët, ndërsa Meksika i gëzohet kualifikimit të merituar.

E DIEL

24 Qershor

2018



NJË PROJEKT i vjetër për Teatrin, PA KULLA, ...në Bibliotekën Kombëtare

NGA BEN ANDONI

Prej ditësh dhe javësh vazhdon një debat i madh për të ardhmen e hapësirës dhe godinës së Teatrit Kombëtar. Në këtë stad janë përfshirë shumë instanca, kurse artistëve në ditët e fundit u janë bashkuar kolegë artistë, aktivistë të shumtë të jetës civile, politikanë, militantë e larmi.

Me vonesë Bashkia e Tiranës ka filluar tryezat me grupet e interesit, ku ka tërhequr vëmendjen për idenë e saj, por edhe ka marrë nga pas të gjithë reagimin e publikut shqiptar. Mes grupeve të interesit janë dy zëra që ndahen sa i përket realizimit të Teatrit, prej nga fillimi, por që brenda shikon tisin e ndihmës ndaj projektit të paraqitur, ku privati do të ndihmojë dhe ngritjen e Teatrit; kurse një zë tjetër, që është më i vendosur dhe përmbledh mesviteti dhe një oponecë të ashpër me qeverinë aktuale, është për ruajtjen e Teatrit Kombëtar dhe për rikonstruksionin e tij, madje duke thënë se nuk ka fare probleme.

Shqetësimi më i madh publik tashmë nuk lidhet më me bërjen apo jo të teatrit, por mos preken e hapësirës së saj, që mëtohet të merret për t'u ndërtuar. E në fakt, kullat që janë pas, ka të ngjarë ta shpërfytyrojnë krejt mjedisin



dhe t'i zënë frymën dhe teatrit, që shteti retendon se nuk i ka fondet e caktuara për ta ndërtuar. Në fakt, edhe kjo e fundit, duket e zgjidhur nga aktorët dhe komuniteti i tyre sepse me një apel publik mendohet se mund të gjenden fondet nga vetë shqiptarët për ndërtimin e godinës.

Godina aktuale ku gjendet edhe sot Teatri Kombëtar nisi dhe u realizua për një periudhë të shkurtër si ambient i përkohshëm. Kjo është përsëritur disa herë. Në studi-

min shkencor të vitit 2007-2008, "Architettura Moderna italiane per le citta D'Albania", theksohet se qëllimi i ndërtimit të kësaj godine që në 1938 nga një kompani italiane ishte shfrytëzimi i ambienteve të saj për arsye argëtimi dhe aktivitete sportive. Ata që e njohin strukturën e saj dinë se aty kanë qenë disa salla, një pishinë, fusha sportive, restaurant etj. "Një vepër në gjendje të përbënte një qendër tërheqëje dhe takimi, dhe gjithçka në një impostim të shëndet-

shëm kryesisht sportiv", citohet në këtë studim nga relacioni teknik i projektit të dërguar nga drejtori i Ndërmarrjes Pater, që do realizonte projektin, në adrese të Ciano-s në shtatorin e 1938-ës.

Për hir të së vërtetës, ndryshe nga italianët, një arkitekt shqiptar me banim në Rumani mendonte ndryshe. Ai kishte gjetur vendin, që "çuditërisht" korrespondon me atë ku ndërtuan italianët, por synimi i tij, ishte që ky

objekt të ishte mbi të gjitha të tjerat. Ai kishte menduar t'i jepte të gjithë rëndesën e duhur në komplekset ndërtimore që po zhvilloheshin asokohe, ndërsa mendonte deri për një Tiranë të shumë kohëve më vonë. Për fat të keq, nuk kemi mundur ta gjejmë projektin, që me siguri, duhet të jetë diku, ndërsa skica të tij gjenden me koleksionet e organit "Shqipëria e Re" në Bibliotekën Kombëtare.

→ Vizion në faqen 14

P

PROJEKTI

Një arkitekt shqiptar me banim në Rumani në vitet '20-'30 kishte gjetur vendin dhe kishte gati projektin e Teatrit Kombëtar të Shqiptarëve, paraqitur në Fakultetin e Arkitekturës në Bukuresht. Ai, "çuditërisht", korrespondon me atë ku ndërtuan italianët, por synimi i tij, ishte që ky objekt të ishte mbi të gjitha të tjerat. Ai kishte menduar t'i jepte të gjithë rëndësinë e duhur në komplekset ndërtimore që po zhvilloheshin asokohe, ndërsa mendonte deri për një Tiranë të shumë kohëve më vonë. Falë një studjuesi që ka preferuar të quhet Bato Oparaku, kemi mundur ta gjejmë projektin, që me siguri, duhet të jetë diku, ndërsa skica të tij gjenden me koleksionet e organit "Shqipëria e Re" në Bibliotekën Kombëtare. ..

Projekti i Teatrit tonë Kombëtar

NGA GJERGJ BUBANI*

Midis të parëve që morën sim vjet diplomë arkitekti në Shkollën e Naltë Arkitekturore të Bukureshtit është dhe bashkatdhetari ynë z.Stavri H.Opari, i biri i patriotit të vjetër z-it Hris-to Opari.

Simpatiku sekretar i Kryekonsullatës z.Nik Pema, duke ma sjellë në njoftim lajmin e bukur, më këshilloi të vete të vizitoj salonin e Shkollës në fjalë, ku janë ekspozuar punimet për diplomë të arkitektëve të rinj, se..." do të shoh diçka që do të më kënaqë".

I shtytur edhe nga kureshtja, por më tepër nga bindja që kam pasur qysh në fillim se studenti i djeshëm Stavri Opari është një nga të rrallët djem punëtorë dhe inteligjentë që kemi, i shoqëruar prej mikut tim Jani Evangjeli, student në Drejtësi, vajta të vizitoj ekspozitën në fjalë. Sa e përlyer, sa e madhe ka qenë surpriza ime, kur, në murin e djathtë të salloni, shoh 16 plane me stemën e Shqipërisë mbi to, që shfaqin planin e plotë të një Teatri Kombëtar në Tiranë.

patur parasysh, sikundër që thamë, mburimet materiale, kjo godinë duhet të jetë një monument arti dhe kulture.

Teatri Kombëtar i Shqipërisë, kështu e emëruamë, por emëri nuk përmbledh mjaftësisht atë që duhet të jetë ky monument.

Nënvizionj se pikspari ky duhet të jetë monument arti urbanistik dhe arkitektonik. Do jetë gjithëkohës vënt theatri, këtu munt të bëhen manifestime muzikale si opera, koncerta etj.

Do ketë salla të cilat do munt të shërbejnë posaçërisht për receptione dhe me një fjalë një llokal i cili të munt t'u përgjigjet gjithë nevojave kulturele.

I zotëruarë prej shumë kohe prej kësaj ideje, realizova një projekt të këtij theatri të cilin e ekspozova në Akademinë e Arkitekturës në Bukuresht.

E para përçapje ishte e rëndë sepse duke patur parasysh se ay do duhet të jetë monument kombëtar, do duhet të përfaqësojë gjithëkohës çfaqjen e një arhitekture kombëtare. Duke mos patur në dispozitë një arkitekturë kombëtare e cila të më japë elementat e inspiracionit pranova idhenë t'a bëj monumentin në një arhitekturë bizantine muslimane me influenca orientale e shikuar nëpër sferën e arhitekturës moderne të kohës s'onë.

Në pak rradhë do tregojmë disa nga pikat e programit: Teatrin e

Arkitekti z. S.Opari, kur ishte në Shqipëri tash e dy vjet me studentët e tjerë të Bukureshtit, zgjodhi vendin ku do të ngrinte (qoftë makar dhe në plan vetëm) Teatrin tonë Kombëtar. E ka vendosur në sheshin kryesor të kryeqytetit përballë pallateve ministrorë. Godina e Teatrit, siç duket në

këtë perspektivë, është monumentale. Tue qenë se ne shqiptarët nuk kemi një stil tonin, autori pranoi si themel stilin bizantin me disa nota shqiptare dhe me një ngjyrë të fortë moderne. Në këtë mënyrë Arkitekti S. Opari kërkoi të jetë sa më afër poezisë së vendit edhe shpirtit shqiptar.

Rreth e përqark Teatrit menazhohet një shesh i fillë që t'u bëjë ballë nevojave të qarkullimit dhe përballë monumentit hapet një arterie e re, e parapamë në planin e ri të kryeqytetit, në mënyrë që perspektiva e pallatit të duket së largu. Sipërfaqja e zënë prej godinës është 40 metrash faqe me 78 metra thellësi.

Plani është bërë për një godinë Teatri dhe Opere së Bashku, për 1000 spektatorë, me skenë dhe foajere të mëdha, siç e lypin nevojat moderne, me kalorifer dhe me gjithë nevojat teknike moderne.

Shtojmë këtu se Këshilli i Profesorëve të Shkollës së Naltë Arkitekturore e pranoi projektin e z-it S.Opari me lëvdatat për autorin. Dhe ne, në rradhën tonë, i shtrëngojmë dorën arkitektit të ri dhe urojmë nga zemra që plani i tij monumental të dojë Zoti dhe politika shqiptare, të vishet me robën e realizimit, qoftë edhe në proporcione më të vogla.

*Shqipëri e Re, 26 Maj 1932, v.XIII, nr.501, f.3- Bukuresht, Maj, 1932

Punim monumental i arkitektit z.Stavri H.Opari




Theatri Kombëtar në kryeqytetin e Shqipërisë

Stavri Opari për godinën

Nënvizionj se pikspari ky duhet të jetë monument arti urbanistik dhe arkitektonik. Do jetë gjithëkohës vënt theatri, këtu munt të bëhen manifestime muzikale si opera, koncerta etj. Do ketë salla të cilat do munt të shërbejnë posaçërisht për receptione dhe me një fjalë një llokal i cili të munt t'u përgjigjet gjithë nevojave kulturele.

I zotëruarë prej shumë kohe prej kësaj ideje, realizova një projekt të këtij theatri të cilin e ekspozova në Akademinë e Arkitekturës në Bukuresht. E para përçapje ishte e rëndë sepse duke patur parasysh se ay do duhet të jetë monument kombëtar, do duhet të përfaqësojë gjithëkohës çfaqjen e një arhitekture kombëtare. Duke mos patur në dispozitë një arkitekturë kombëtare e cila të më japë elementat e inspiracionit pranova idhenë t'a bëj monumentin në një arhitekturë bizantine muslimane me influenca orientale e shikuar nëpër sferën e arhitekturës moderne të kohës s'onë.



Godina e Teatrit

Godina aktuale ku gjendet edhe sot Teatri Kombëtar nisi dhe u realizua për një periudhë të shkurtër si ambient i përkohshëm. Kjo është përsëritur disa herë. Në studimin shkencor të vitit 2007-2008, "Arhitektura Moderna italiane per le citta D'Albania", theksohet se qëllimi i ndërtimit të kësaj godine që në 1938 nga një kompani italiane ishte shfrytëzimi i ambienteve të saj për arsyë argëtimi dhe aktivitete sportive. Ata që e njohin strukturën e saj dinë se aty kanë qenë disa salla, një pishinë, fusha sportive, restorant etj. "Një vepër në gjendje të përbërë një qendër tërheqëse dhe takimi, dhe gjithçka në një impositim të shëndetshëm kryesisht sportiv", citohet në këtë studim nga relacioni teknik i projektit të dërguar nga drejtori i Ndërmarrjes Pater, që do realizonte projektin, në adresë të Ciano-s në shtatorin e 1938-ës.

NGA ARH STAVRI HR. OPARI

Dyke patur parasysh gjendjen të sotmen, shteti shqiptar i cili ndodhet në plot epokë konstruktive, duhet të hedhë vështrimet reth e përqark tij dhe të kqyrë ç'do send që të tjerët kanë krijuarë gjer tani dhe përfundimet në të cilat arinë në ç'do fushë.

Në këtë mënyrë do mund të përfitonjë nga përfundimet që të tjerë realizuan me anën e një eksperience të gjatë.

Dyke kthyerë vështrimin tek fusha mi të cilën sot në Shqipëri shillohet një aktivitet më i gjërë e cila është konstruktive si: Pasunimi i kryeqytetit dhe qyteteve të tjera me godina administratore dhe kulturore, marr lejën të bëj disa vërejtje speciale.

Cështja është mjaft e gjërë që të munt vetëm në disa shtylla të flas për gjëra, të cilat janë shkruarë volume të tëra, por do të kufizohem vetëm të het një vështrim të shkurtër mbi monumentat administrative dhe kulturele. Vendi ynë dyke qenë i vogël, është gjë e natyrshe që edhe nevojat e tij të ç'do pikëpamje janë të vogla. Por gjithë kohës dhe mbarimet e të ardhurave janë të vogla dhe si konsekuencë logjike dhe posibilitet për realizim. Dyke mbajtur hesap për ato q'u realizuan gjer më sot si edhe për projektet për të arthmen, vemë re se nevojat e urdhrat administror gëzuanë një kujdesje më të madhe (mi këtë gjë do vin) në një numër tjetër me një studim të posaçëm) duke u neglizhuar ato të urdhërit kultur-al.

Është e vërtetë se në një shtet të ri nevojat e urdhrat administrativ janë ato që imponon me parë por është gjithë aqë e vërtetë se lidhjet midis bamirësve gjith po t'atij vendi si edhe midis popujve të ndrysh-më fitohen me anën e një bashkimi shpirtnor; i cili bashkim fitohet vetëm me anën e manifestatve të artit dhe të kulturës.

Vendi ynë është i pasur me elementa të vlefshëm sepse perëndia e pajosi popullin jo vetëm me cilësira luftëtare por edhe me cilësira artistike për të cilat sot, më të shumtat, janë vënë në shërbimin e të tjerëve.

Përse të gjitha këto elemente të vlefshme mos bashkohen në një tufë, atje në vendin t'onë, dhe me burimet e tyre të pashterura të ngrënë nivelin kulturall të vendit?

Gjithëkohës dhe të huajt të mund të vinë ndër në duke u bërë dhe e përkundërta dhe këshilloj të bëhen lidhje shpirtnore midis nesh dhe të tjerëve, lidhje që janë aqë të nevojshme në ditët e sotme.


Por për këtë gjë duhet pikëspëri të ngrihet një godinë e cila të munt t'u përgjigjet këtyre nevojave.Duke

Një projekt i vjetër për Teatrin, pa kulla, ...në Bibliotekën Kombëtare

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 1

Për hir të së vërtetës, ndryshe nga italianët, një arkitekt shqiptar me banim në Rumani mendonte me një ide tjetër. Ai kishte gjetur vendin, që “cuditërisht” korrespondon me atë ku ndëruan italianët, por synimi i tij ishte që ky objekt të shfaqej mbi të gjitha të tjerat. Ai kishte menduar t'i jepte të gjithë rëndësinë e duhur në komplekset ndërtimore që po zhvilloheshin asokohe, ndërsa mendonte deri për një Tiranë të shumë kohëve më vonë. Për fat të keq, nuk kemi mundur ta gjejmë projektin, që me siguri, duhet të jetë diku, ndërsa skica të tij gjenden me koleksionet e organit “Shqipëria e Re” në Bibliotekën Kombëtare.



të fortë moderne. Në këtë mënyrë Arkitekti S. Opari kërkoi të jetë sa më afër poezisë së vendit edhe shpirtit shqiptar.

Rreth e përqark Teatrit menazhohet një shesh i tillë që t'u bëjë ballë nevojave të qarkullimit dhe përballë monumentit hapet një arterie e re, e parapamë në planin e ri të kryeqytetit, në mënyrë që perspektiva e pallatit të duket së largu.

Sipërfaqja e zënë prej godinës është 40 metrash faqe me 78 metra

thellësi.

Plani është bërë për një godinë Teatri dhe Opere së Bashku, për 1000 spektatorë, me skenë dhe foajere të mëdha, siç e lypin nevojat moderne, me kalorifer dhe me gjithë nevojat teknike moderne”, shkruan Gjergj Bubani.

Kanë kaluar vite dhe Shqipëria nuk e bëri dot një teatër të tillë, përveçse mbolli mëri dhe nuk la njeri pa nëmur, që mendoi ndryshe për teatrin kombëtar të shqiptarëve. Që nga largësia e viteve po ua sjellim dhe njëherë idenë e këtij arkitekti interesant, Shqipëria e të cilit ishte një Zonjë e Bukur.

Ja se çfarë shkruan mjeshtri: “Nënvizonj se piksiri ky duhet të jetë monument arti urbanistik dhe arkitektonik. Do jetë gjithëkohës vënt teatri, këtu munt të bëhen manifestime muzikale si opera, koncerta etj.

Do ketë salla të cilat do munt të shërbejnë posaçërisht për receptione dhe me një fjalë një llokal i cili të munt t'u përgjigjet gjithë nevojave kulturele.

I zotëruarë prej shumë kohe prej kësaj ideje, realizova një projekt të këtij teatri të cilin e ekspozova në Akademinë e Arkitekturës në Bukuresht.

E para përçapje ishte e rëndë sepse duke patur parasysh se ay do duhet të jetë monument kombëtar, do duhet të përfaqësojë gjithëkohës çfaqjen e një arkitekture kombëtare. Duke mos patur në dispozitë një arkteturë kombëtare e cila të më japë elementat e inspiracionit pranova idhenë t'a bënj monumentin në një arkitekturë bizantine muslimane me influenca orientale e shikuar nëpër sferën e arkitekturës moderne të kohës s'onë.

Në pak rradhë do tregojmë disa nga pikat e programit: Teatrin e vendosa na pjacën principale të Tiranës. Përpara dhe rreth tij krijova një pjacë të vogël e cila të shërbejë për vaturat dhe të madhohjë efektin perspektiv të monumentit.

Monumentin do jetë i rrethuar prej rrugësh. Përpara tij do hapet një rrugë e paravështruar prej planit për sistematizimin e qytetit e cila permeton se monumenti të duket prej distance të madhe dhe në tërë madhëstnin e tij. Lokali zë një faqe prej 40 metra, me 70 metra thellësi dhe përmbledh: sallë për çfaqje teatrale, konferenca etj., e përbërë prej parteri lozhash dhe balkonesh”.

Një ëndërr e bukur, por që do të bëhej realitet nëse arkitektët tanë do të mund t'i ktheheshin duke i sugjeruar të gjithë palëve sesi mund të ndërrojmë të ardhmen, me ndihmën e së shkuarës. Thjesht, ia vien të shkosh në Bibliotekën Kombëtare dhe të marrësh një projekt, që fle prej shtatë dekadash...pa kulla, sigurisht.

(Milosao)

*Arh Stavri Hr. Opari-
"Shqipëria e Re"




Teatri Kombëtar Bukuresht

vendosa na pjacën principale të Tiranës. Përpara dhe rreth tij krijova një pjacë të vogël e cila të shërbejë për vaturat dhe të madhohjë efektin perspektiv të monumentit.

Monumentin do jetë i rrethuar prej rrugësh. Përpara tij do hapet një rrugë e paravështruar prej planit për sistematizimin e qytetit e cila permeton se monumenti të duket prej distance të madhe dhe në tërë madhëstnin e tij. Lokali zë një faqe prej 40 metra, me 70 metra thellësi dhe përmbledh: sallë për çfaqje teatrale, konferenca etj., e përbërë prej parteri lozhash dhe balkonesh.

Foyer-i hyrjes në sallë duke pasur dhomën e garderoberës dhe aneksat e tjera si fumoira, sallona etj. Hal-

HISTORI
Autori ka bërë një përshkrim të kohës që përkon me shekullin e XV dhe rolin e Gjon Gazullit, që sipas tij mund të quhet “diplomat profesionist”, duke qenë se qysh në kohën e lëvizjeve kryengritëse të prijësve arbër më 1432 ai del të ketë shërbyer si ambasador i Republikës së Raguzës pranë Perandorit Sigismund..



Kur Skënderbeu merrte borxh!

NGA GJON MARKU

Vijon nga numri i shkuar

Megenëse negociatat me qeverinë venedikase nuk dhanë rezultat Skënderbeu iu drejtua për ndihmë mbretit aragonas Alfonsi V, i cili ishte kundër aspiratave pushtuese osmane në Gadishullin e Ballkanit, si dhe kundër mbizotërimit të Republikës së Venedikut në Adriatik. Perfaqësuesi i Alfonsit V dhe Skënderbeu lidhen marrëveshjen “Gatë”, më 26.III.1951.⁽²³⁾

“Alfonsi u angazhua se do ta mbronte Skënderbeun, familjen dhe faretin e tij, se do të ndihmonte me ushtri, me të holla dhe do ti respektonte privilegjet që i kishte pasur e tërë Shqipëria. Skënderbeu u zotua se mbretin Alfonsi do ta njihte si zërin në rastet, kur do ti afrohej ndihma ushtarake në luftë kundër pushtuesve osmanë. Detyrimet që i mori mbi vete, të dyja palët u plotësuan vetëm pjesërisht. Alfonsi V, pas nënshkrimit të marrëveshjes, dërgoi në Shqipëri një njësi ushtarake prej 100 ushtarësh, e cila u vendos në Krutë, Mirëpo Skënderbeu nuk e bëri betimin e besnikërisë ndaj mbretit aragonas Alfonsi V.”⁽²⁴⁾

Strategu dhe udhëheqësi i kryengritjeve shqiptare, duke marrë parasysh namin dhe

cilësitë e larta të Gjon Gazullit, e caktoi atë në një mision special, që në emër të tij të shkonte në Vatikan. Vajtjen e Gjon Gazullit në Vatikan e shfrytëzuan dhe raguzianët për interesat e veta.⁽²⁵⁾

“Sipas një vendimi që mban datën 27.II.1451, ata e angazhuan Gazullin në emër të Senatit të luste Papa Nikolla V, që ky me autoritetin e vet të bënte të mundur lirimin e qytetit të Raguzës nga tatimet e zakonshme për vitin jubilar, këtë kërkesë Raguzianët e bënin me pretektstin se kishin merita të mëdha për mbrojtjen e interesit të krishterimit, në veganti për popullarizimin e luftës së Skënderbeut. Papa duke qenë në koherencë të ngjarjeve, bëri zgjidhjen që ti kënaqte të dyja palët.

Në vitin 13.IV.1451 Papa Nikolla V urdhëroi Ipeshkvin e Kotorrit, Bonin de Tolentis dhe Vikarin e Arqipeshkvis së Raguzës, Gjon Gazullin, rektor i Kishës së Shën Pjetrit, që një pjesë të shumës së fituar nga indulgencat e vitit jubilar 1450 t'ia dorëzojë Gjergj Kastrioti Skënderbeut ose njerëzve dhe besnikëve të tij, “zot i Krutës e i Arbënisë”, vazhdimisht po u qëndron me trimëri dhe guxim turqve dhe po lufton me ta.”⁽²⁶⁾

Më 25.V.1451 Papa Nikolla V kishte ngarkuar Gjon Gazullin, Bonin de Tolentis, e një të tretë për të mbledhur të holla nga indulgjen-


→Vijon në faqen 18

P

POEZIA

Në stilin e zakonshëm gati kozmogonik vjen ky cikël i propozuar nga autori për këtë numër të "Milosao", i marrë nga libri i porsabotuar poetik "Këmbësori poetik"...

Këmbësori i fantazisë në qiell



NGA MOIKOM ZEQU

Shiu i befte i prillit, - e bën karrocën e tij, - fluturoese, - me florinj efermerë. - Ku nxiton? - Ku vallë?

Unë ngre dorën, - e përsëhendes!

Ah, Helena e Trojës! - Ajo, - qe kësh-tjella, - ku qenë, - burgosur sëbashku, - dhe akejtë, - dhe trojanët. - Përtej mureve, - qe - vetë Helena, - brenda, - mureve, - tërë kacafytja, - për vdekje, - e luftëtarëve, - që vriteshin, - me tmerr, - për të njëjtën gjë! - Pa kuptuar - asgjë!

Krishti furnizon
Me peshq të rinj
Restorantet politike,
Të Wallt Street-it.

Dhe drurët
Grumbullohen mbi mal,
Si dishepuj të motshëm
Të Diellit!

Vjen Endacaku i yjeve,
I pluhurosor me kozmogoni,
Pastaj Acari
Si Antikrishti i Madh!

Ç'kaktusë të birësuar
Nga deti Jon,
Hapësira e klonon vetveten
Në njëmijë shtrëngata.

Dhe pastaj
Do të shfaqet
Vetë Vdekja
Si një orgazmë madhështore!

Si t'i ngjiz këto ëndërra
Në martesë me detin?
Si bandit i kënaqësive
Unë dhe mitet i plaçkis!

Sqepa zogjsh
Si gjilpëra gramafoni,
Katër pllaka horizontesh,
Me muzikë shekujsh!

Nga bakri
I këtij mangalli antik,
Do të bëj hajmali
Të Kujtesës së Humbur!

Do të zhduket shekulli i vjetër
Si heqja e një mjekre të rreme,
Po drita boreale e mollëve
Në fakt, nuk ndriçon askënd!

Do të mbetem
Krejt i vetëm
Si mbretëresha e bletëve
Në një zgjua shahistik!

Kush, - i di, - rrugët, - e fjalëve, - në ajër? - Pse - Kujtesa, - është, - udha, - ku shpesh, - nuk mund, - të ecë, - askush?

Pena e mprehtë
E Migjenit
Është banesa e rrufeve foshnja,
Jetimet e Arsyesh!

Te dora delikate
E Ofelisë
Hamleti rëndon
Si byrzylik!

Nëdërsa ky kalë Swiftian
Bëhet prangë
Në dorën time
Të shkrimit.

Prejardhje, - të errëta, - të domethënieve! - Gjithçka, - rrotullohet! - Gëzimi, - i të jetuarit! - Imagjinatë, - përrallëzuese, - plot etje, - për jetën! - Martirizim, - i rëndë, - paleokristian, - i emrave! - Tempuj, - qiellorë, - po pa zota! - Vallë, - statujat, - do të kthehen, - në feminine, - e shkëmbejve, - të lashtë? - Çdo flatër zogu, - është, - një shpikje, - kundër, humnerave, - rëndësës, - dhe boshllëkut! - Dhe - ky avion, - në horizont, - është, - shkumësi, - me të cilin, - shkrova, - dikur, - në dërrasën, - e zezë, - të shkollës, - fillore! - Dhe, - drita, - vjen, - mbi mua, - nga ca lartësi, - që i venë, - në lëvizje, - ca zemra, - të padukshme, - ose motorë, - idesh, - që ende, - nuk janë, - prishur, - dhe ndryshkur, - përgjithmonë!

Nga germat - e zeza - frymon - një dritë - metafizike! - Dhe - përballë - meje - duket - fytyra ime - e dytë, - e panjohur! - Eci - në malin - e shurdhët, - pa hije, - pa flade, - ngre - perden - jeshile - të Heshstjes - për të hyrë - brenda!

Unë, - jam, - një, - nga, - fëmijët, - e natës! - Ç'është, - e kjo formë, - e ftohtë, - e zbrastërës? - Fluturon, - floku, - im, - i erërave. - Në damarët, - e bimëve, - shket, - mendimi. - Hija, - e pavërtetësisë, - më ndjek, - me flutura, - të zeza! - Si kronist, - i ëndërrave, - duart, - i kam zhytur, - në dete iluzionesh! - Janë, - sfillitur, - Lajmëtarët, - e Pranverës! - Nga çezmat, - rrjedhin, - eposet, - e harruar! - Kush, - mua, - m'i mbledh, - hapat, - dhe - më fut - në paqenësi?

Oktavio Paz tha:
« Të gjithë ne jemi kohë,
S'janë vitet ato që kalojnë,
Jemi ne! »

Statuja e Skënderbeut me kalë,
Shët në Shans-Elizë,
Në Ishullin e Pashkëve,
Madje dhe në Atlantidë.

Kur kam ftohtë
Vetvetiu zgjohem
Te një përrallë,



Që digjet!

Centauri Mjekërblu,
Më tregon rrugën,
Tek Taverna Kozmike,
E Khajamit!

Si mund ta dimë,
Që kjo salamandër
E fabrikon një botë arti,
Që kurrë s'u arrit?

Rripet si lëkura ime, e djegur,
Ky realitet i vrazhdë
I kriminalizuar
Nga paraja!

Tek hija, që le,
Në shkrëtitirë,
Hapet dritarja,
E një bote arkeologjike!

Vajzat e Avinjonit,
I shkulin flokët Mona Lizës!
Populli i pikturave
Ç'njerëzim i dyzuar!

Çdo risi
Bëhet prap rutinë!
Dhe lulet janë
Kafshëza bimore!

Nga syri i Zotit, Zotit,
Duan ta nxjerrin
Si drudhëzë
Vetë Shekspirin!

Poeti, - është, - hibridi, - i murgut, - me martirin!

Vërtetë, jam - detar - (mbase pirrat) - i fjalës, - por - edhe këmbësori - i Fantazisë, - në qiell!

Kotësi! - Kotësi! - Piktura, - të thurura, - merimangash! - Testament, - prej hiri, - i Harresës!

Dhe lulet, - e thara, - janë, - mesh-tarë, - të vdekur, - në kishën, - e brak-tisur, - të stinëve!

Durrës, 13 shkurt, 1998

SHTRËNGATAT PRINCËR

Tek kjo kokërr arre,
Që bije në trotuar,
Mbase është varri im!

Si janë ëndërrat
E erëra?

Mes paradokseve, i kam disa mo-

tive gëzimi, si **dallëndyshe dimri!**
Dhe i zbukuroj fjalët me heshnje!
Një pishtar vrapon para, një pishtar triumfues, por unë s'e ndjek dot!
Brenda emrave të **Homerit** dhe të **Whitmanit** janë oraret, kur punon **Historia**, jashtë tyre, ka veç plogështi dhe gjumë.

Gjethet rrëzohen në skajshmëri
Si ceremoni parade!
Unë thith energji të mëdha
Nga idetë e të vdekurve!

Fjala ndriçohet nga brenda
Ashtu si detet e De Radës
Plot lëvizje kohërash
Dhe përtëritje të pabesueshme!

Çdo peshk
Ka kthetra zogu!
Por vetëm zemra
Është amfibi më i rrezikshëm!

Dhe vullkani,
Që shpërthen,
Është gjeneza
Që tek Pikaso bën Guernikën!

Kuptoje detin si **Noclon përdëllim!**
Më shumë se masë ujërash, kaktuset
Si poetikë surrealistë dhe jo si janë
Në të vërtetë, dashuria s'është
Thjesht femra, - hiret e saj s'humbin
Me trupin që mplaket.

Ç'kohë! **Të ekzistosh s'do të thotë Se je!** Varfërohet kuptimi, fruti i ri
Bëhet pluhur! Por uji i mistershëm vërshon
Si në ereksion! Mund të gjesh një amforë antike -
Ëndërr qiellore të së ardhmes, por eukaristia
Është formë e pakapshme!

Ja manastiret mesdhetare plot ullinjinj
Dhe pulëbardha, (ku murgjit u ngjajnë)
Më shumë ullinjinje, se sa pulëbardhave!
Shoh Centaurët groteskë të reve,
Që bëhen shkëmbej vulgarë,
Se Princesha Imagjinatë ka vdekur para Krishtit!

Mali Tomor rri pezull. Po e tashmja
Ku është? Ngjarjet i shohim
Si centurionët e vrazhdë romakë
Në Golgota, që s'kuptonin, - ahëre
Çfarë ndodh s'është diçka e re,
Kahja s'perceptohet, **tragedia S'ka kum!**

HISTORIA

→ Vijn nga faqja 15

cat që i bën Papa popullit, në qytetin e Raguzës e nëpër krahina të ndryshme. Gazulli ka shkuar të vizitotë "magnificus Georgius Cstriottus" (është dhe emri "Skënderbe") për shkak të mosmarrëveshjeve me duken Stefan (të Bosnjës), po sidomos për shkak të murtajes që po rrezikon vendin, shpallja e indulgencës të shtyhet, por afati të mos kalojë të gjashtë muajt. (Radoniç 41.Jorga , NotesII 448).⁽²⁷⁾

Më 18.III.1452 Eugjen Summa, "Episkop Prokurator i gjithë Arbëris, në emër të të madhënismit dhe të shkëlqyeshmit zotit Gjergj Kastrioti, Alias Skanderbeg", komandon dhe me letër të kapëdanit të Lezhës, merr në noteri dhe kancelari të Raguzës, nga dora e Bonin de Tolentis, vikar i Arqipeshkvit Jakob të Raguzës dhe nga mjeshtri Gjon Gazulli, tagra mbledhës i dërguar nga Selia Apostolike, 4893 perperë që i përkasin Skënderbeut. Ato janë nxjerr nga dhuratat e vitit 1451, dhënë për ndjesitë e shpallura nga papa Nikola i V, pasi janë zbritur shpenzimet e bëra.(Radoniç. 51.)⁽²⁸⁾

18 Mars 1452

Procesverbal i mbajtur në Raguzë më 18 mars 1452, i cili vërteton se ambasadori i Skënderbeut, Peshkopi Andrea Suma ka tërhequr shumën 4893 dukatë arë grumbulluar me nismën e selisë apostolike, si ndihme për luftën e shqiptarëve kundër invazioneve osmane.

Në prani të: Niksa de Giue, zotit Marku e zotit Nikollë Salomoni, mjeshtri Gjon Matia, mjek, ciroik, rroghtar nga komuna e Raguzës, Forte Antoni nga Kursola, Luk de Florentina, Filip de Arimino, Karluç Aluizi nga Marfredonia duke pasur dëshmitarë e të pranishëm, të thirrur e të pyetur për këtë gjë dhe të tjerë, aty i përnderuari në Krishtin at zot Andrea Suma. Peshkop, prokurator shumë i denjë i gjithë Shqipërisë, për hir të zotit e të Selisë Apostolike, e prokurator me emër të madhërismit e të të shkëlqyerit zotit Gjergj Kastrioti i quajtur Skënderbe, i pajisur me mandatë të posaçëm, sikur del nga prokura shkruar me shkresë publike dhe shpallur nga dora e burrit të urtë Mikel de Nikolai, i noterit me autoritet publik të përgjithshëm e tani kancelar i Lezhë., Në mijëveçarini dhe në indeksionin e tanishëm data e saktë, 18 shkurt, dhe duke qenë i rekomanduar me anë të letrës së zotit kapidan të Lezhës, të nënshkruar në këtë shkresë, me vule autentike të qeverisë së Shën Markut, që bëjnë dëshmi për ligjshmërinë e noterit e të kancelarit të mbitbënë, si shihet e lexohet nga unë, noter i nënshkruar; dëshmoi dhe tregoi i kënaqur se po merrte në dorzim në emër të prokurorit sipërpërmendur dhe në emër të tij. Pranonte se i janë dhënë gjithsej një nga një të numëruara me dorë nga të ndëruarit etër në Krishtin zotëriun Bonino de Telenti, Vikar i shumë të përndriturit kryepeshko-



Kur Skënderbeu merrte borxh!

pit raguzian dhe nga mjeshtri Gjon Gazulli, tagrambledhes e mbikayrës të dërguar nga selia apostolike, e zbatues të letrës apostolike dhënë të lejuar për Jubilenë e shenjtë. Këta kanë dërgjur e kanë dorëzuar, dukatë, moneta, rauba, perpera 4893, sa i përkasin Skënderbeut si të holla të tij, duke nxjerr domosdo shpenzimet e bëra për shpërblimin e plot të ndërmjetësisë së tij; dhe këtë shumë duhet ta marrë në bazë të koncesionit të bërë nga selia apostolike, nga të gjitha dhuratat e kontributet e para të mbledhura, ta nxjerra, të marra - me rastin e Jubileut sipas bulave apostolike që kanë ardhur për këtë qëllim, të dhëna në vitin e zotit 1451, 18 prill, viti i pestë i pantifikatit të Zoit tonë Shenjtë Papa Nikolla V. Për këtë arsye, ai zoti Peshkop, me cilësinë e tij si prokurator, si më sipër, i bëri zotëri Vikarit e zotëri Mjeshtrë Johan, tagrambledhës, mbikëqyrës dhe zbatues të shkresave të sipërthëna, përfundimin e detyrës, lehtësimin, qetësimin, zgjidhjen dhe paktin në bazë të të cilit ai nuk do të kërkojë nga ndërmjetësia e bërë në rastin e Jubileut të sipërpaguar gjë tjetër; që ti përkasin zotit Skënderbe, që rrjedh ngatë hyrat dhe të ardhurat e bëra me atë rast, të nxjerra nga të gjithë e nga secili, të mbajtura prej tyre në atë periudhë kohe. Gjithash-tuq dorë nga çdo e drejtë ose vepërin dhe i zgjidh e i liroj ato zotëriun tagrambledhës, ekzaktor e zbatues të bulave apostolike nga të gjitha e nga çdo detyrim tjetër që mund të kërkohet nga të sipërthënë. Dhe u siguron me cilësinë e tij si prokurator, se as ai e asnjë prokurator tjetër i zotit Skënderbe, as trashëgimtar e pasardhës i tij nuk do të kërkojë më tepër; nuk do të lypë nga ata tagrambledhës, ekzekutor së bashku ose nga secili prej tyre dhe kurr kundër tyre nuk do të ngrihet çështje që u tha më sipër. Çdo gjë që u shkrua do të forcohet me firma dhe do të rati-fikohet me mirënjohje duke renouvar çdo ligj, statut e të drejt ndi-

Procesverbal mbajtur për paratë e Skënderbeut

18 Mars 1452
Procesverbal i mbajtur në Raguzë më 18 mars 1452, i cili vërteton se ambasadori i Skënderbeut, Peshkopi Andrea Suma ka tërhequr shumën 4893 dukatë arë grumbulluar me nismën e selisë apostolike, si ndihme për luftën e shqiptarëve kundër invazioneve osmane.

hme të përgjithshme në rast se del ndonjë kontradiktë në të ardhmen. Kjo letër është botuar për herë të parë në shqip nga Kristo Frashëri në botimin e Akademisë së Shken-cave të Shqipërisë "Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV" (Vëll.I Tiran 2005.)⁽²⁹⁾

Më 8.II.1453 Vladislavi i Bosnjës (djal i Stefanit) i përgjigjet Raguzës se nuk ka gjë kundër saj dhe se e kanë mashtuar: Raguzia i lutet që të mos vijë atje. ambasador është Gjon Gazulli, të cilit i jepen 40 perperë dhuratat në stof.Jorga, Notes II 486, sh.1.

Në një dokument të datës 19.XII.1455 Gjon Gazullin e gjejmë sërish ambasador të Skënderbeut. Në këtë kohë humanisti dhe diplo-

mati ynë i shquar u angazhua për çështjen e lirisë, lidhur me lundrimin e raguzianëve në limanin e Rodonit, i cili në kohën e luftës së popullit shqiptar me Skënderbeun në krye, paraqet rol me rëndësi për eksportin dhe importin e Republikës në Shqipëri.

Për Gazullin në vitet 1453-67 jepet një biografi kryesisht të karakterit arkival, Pal. Rapportii it.-alb 160, sh. 154. Ne ato vite ai ka qenë ambasador i Skënderbeut në Raguzë (IX.53), të papa Nikolla VII (1454), të duka i Bolonjës dhe tek ai i Milanos (1456) përsëri në romë (15.II.1458), për tu kthyer në Raguzë (III-IV. 1459) më vonë në Venedik (XII.1463) dhe përsëri në Romë (IV. 1465) ishte ndër më të besuarit bashkëpunorë të princit shqiptar të papa, sa herë vajti, mori ndihma në të holla për Skënderbeun. (Shif. Jorga, Notes II 485, Archiv. Stor.it. CXIV 732; Gelcich- Tha llocczy, Diplomatarium Ragus.745; Radoniç 178, 181-2; Miklosich, Mon. Serb. 481-3; Ljubiaex 293, e quajn De gazolis, de Gazolis)⁽³⁰⁾

Në vitin 1457 Gjergj Pleini, së bashku me Gjon Gazullin është përmendur si anëtar të një misioni diplomatik në Itali.⁽³¹⁾ Në përpjekjen për të siguruar ndihma në të holla, Pelini në misionin diplomatik të 1457 shkoi në romë të Papa Klalisti



II, kurse një vit më vonë e gjejmë të angazhuar në pajtimin midis Skënderbeut dhe Venedikut.

Gjon Gazulli mund të quhet "diplomati profesionist", duke qenë se qysh në kohën e lëvizjeve kryengritëse të prijësve arbër më 1432 ai del të ketë shërbyer si ambasador i Republikës së Raguzës pranë Perandorit Sigismund.⁽³²⁾

Raguzia ka pasur vazhdimisht marrëdhënie të shkëlqyera me Shqipërinë e pa diskutim Gjon Gazulli është një faktor i rëndësishëm në krijimin dhe qëndrueshmërinë e këtyre marrëdhënieve. Ai ishte qytetar i qytetit të Raguzës me gjak shqiptari, i cili përcillte me interesim të madh ngjarjet në Shqipëri.

Gjon Gazulli shfaqet si një person me aftësi të rralla në fushën e diplomacisë e shquhet si një ndër diplomatët më të zotë të kohës. Vetë situatë e krijuar dhe aktiviteti i tij i gjerë dhe i spikatur bënë që ai të hynte në mënyrë aktive në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve politike të kohës. Ndërsa vendet ballkanike bënin rezistencë ndaj gjendjes së krijuar nga sulmet e drejtpërdrejta të Turqve, qarqet diplomatike europiane dhe shtetet e Europës zhvillonin një aktivitet të gjerë diplomatik, kundër deportimit të mëtëjshëm të osmanëve prandaj ato nxisnin dhe përkrahnin rezistencën e popujve të Ballkanit e kjo ishte e lidhur drejtpërsëdrejti në mbrojtje të interesave të tyre e në radhë të parë të lirisë së tyre. Dihet se qendra kryesore e kësaj diplomacie ishte Roma dhe vendet e tjera të Italisë dhe në anën tjetër Hungaria Në këtë vepërimari politike dihet se rolin kryesor e kanë luajtur intelektualët e kohës, njerzit e shkolluar e sidomos ato që ishin shkolluar në shkollat e këtyre vendeve.

Në misionet diplomatike janë të angazhuar shumë personalitete diplomatike por Gjon Gazulli është një mision special, që në emër të Skënderbeut të shkonte në Vatikan e këtë shpesh e shfrytëzoi dhe Raguzia për interesat e veta, ai shquhej për shkathtësinë dhe inteligjencën e tij.

Nuk u ndalim këtu në fjalimin e mbajtur prej Gjon Gazullit në Prani të Papa Nikollës V, në Romë në vitin 1451 pasi ai fjalim është botuar i plotë në revistën Leka, Shkodër, nr. 1-2, 1939 (shtojçë). Prof. Pal Nikolli e cilëson Gjon Gazullin si figurë ndër më të shquart e diplomacisë dhe shkencës europiane të shek. të XV-të.

Shënime
23. "Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë II", fq. 308, Tiranë, 1962
24. Dranqulli, Jahja, "Francia e shqiptarëve në Raguzë gjatë shek. XII. XV "Gjurmime silbanotologjike", Serbia e shkencave historike I, XV, fq. 69, 16-1986, Prishtinë, 1987.
25. Radoniç, J. Djuaraj Kastrioti Skënderbeg, 21 s.
26. Bullarium Franciscanum I 1071. Radoniç 40 Shuteriqi, Dhimitër. "Moti i Madh" përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479" Shhtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2006.
27. Shuteriqi, Dhimitër. "Moti i Madh", përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479. Shhtëpia botuese "Dituria", fq. 168, Tiranë, 2006.
28. Shuteriqi, Dhimitër. "Moti i Madh" përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, fq. 176 Shhtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2006.
29. Frashëri, Kristo. "Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV", Vëll. I, fq. 66, "Akademisi së Shkencave të Shqipërisë", Tiranë, 2005.
30. Shuteriqi, Dhimitër. "Moti i Madh" përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, fq. 176 Shhtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2006.
31. Berisha, Gjon. "Arbnorë ndërmjet Kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shekullit XI-XV", fq. 554, Prishtinë, 2015.
32. "Diplomatarium relationum Reipublicae Ragus", 368-369 (DAD).
33. Nikolli, Pal. Llusku, Bib. Gazeta Rilindja, Tiranë, nr. 582, fq. 77, maj 1995.

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri iu dedikua shkrimtares së ndjerë kroate Dasha Mrdiç. Ajo ndërroi jetë gati dy javë më parë në Rijekë ku edhe u varros. Si mike e madhe e shqiptarëve dhe duke lënë një trashëgimi të bukur për vendin tonë, mes të tjerave edhe shumë pasazhe në veprën e saj, për të mos thënë dhe një koleksion të bukur të reportazheve për të, përkthyesi i saj (redaktori), mendoi ta kishte në faqet e veta me të gjithë nderimin e duhur. "Një anti-komuniste e bindur dhe një njeri pa shumë etiketa, kur duhet të thoshte të vërtetën, ajo ka ndarë me shqiptarët e letrave dhe miqtë e saj në Ballkan momente të mira reflektimi dhe qasje të shkuarës. "Unë kam gërmuar të gjitha varret e imagjinatës dhe dëshirave... Jam rrotulluar nëpër një seri të ruajtur të vërtetash pa gjetur një gjurmë logjike".

Në këtë numër bëme një paraqitje edhe të botimit të ri të Elena Ferrantes, autore, që shkruan me pseudonim dhe që tashmë ka disa libra në shqip. Agim Doksan, që e ka përkthyer, meriton të gjithë vlerësimin për punën e madhe por edhe angazhimin e tij të vazhdueshëm.

Autorja ka rreth dhjetë vepra letrare, ndër të cilat edhe të ashtuquajturën saga napolitane, e konsideruar si kryevepra e saj, nga pikëpamja e kritikës letrare, që ka shënuar sukses me lexuesit. Gjon Marku në arealin e vet të studimeve ka bërë një përshkrim të kohës

që përkon me shekullin e XV dhe rolin e Gjon Gazullit, që sipas tij mund të quhet "diplomati profesionist", duke qenë se qysh në kohën e lëvizjeve kryengritëse të prijësve arbër më 1432 ai del të ketë shërbyer si ambasador i Republikës së Raguzës pranë Perandorit Sigismund. Duhej ta shkruante pak më mirë, por shpesh autori duket disi i nxituar për të dhënë një informacion me të cilën ai krenon në të vërtetë trevën e vet.

Ndërkohë një lajm i mirë nga karikatura, sepse në konkursin botëror të zhvilluar në Qipro, ku morën pjesë rreth 348 karikaturistë nga 64 vende të ndryshme të botes, e ku janë paraqitur plot 802 punime, karikaturisti Arben Meksi u nderua me çmim special. Ky konkurs trajtonte temën e ruajtjes së Paqes në botë, e shprehur përmes simbolit të pemës së ullirit. Ideja që ka paraqitur autori në këtë punim, janë pemët e prera të ullirit dhe pëllumbi, i cili fluturon sipër tyre me folenë e lidhur pas trupit duke mbajtur në sqep degën e ullirit, duke shpëtuar kështu simbolin e paqes. Siç ndodh në Shqipëri, ky lajm kaloi pa shumë bujë, por me gëzimin e çiltër të Meksit, një njeri që e do dhe e ndjek bajagi kulturën.


Në përgjithësi ishte një numër i mirë dhe prania e Dashës dhe kujtimi i saj ishte një bekim i bukur. Layout punoi në limitet e kohës por sërish veprimi mirë, kuptohet pa i lënë vend redaktorit të punonte pak më shumë me korrigjimet.



Maks Velo, në kuadër të cikleve të tij dedikuar udhëtimeve dhe perceptimeve të muzeve ndërkombëtare, na ka sjellë frymëzimin e tij para modeleve imagjinare, mu ato që kanë frymëzuar në kohën e tyre Matisse dhe Pikaso. Vetëm se në ndryshim nga mjeshtrat, ai mundohet të penetrojë natyrshëm stilin e tij dhe të jetë sa më afër vëzhgimeve të mjeshtrave, kuptohet me erën e vet. Duket si një ushtrim, por në këtë rast, Maks Velo e përdor për të shijuar mrekullinë e artit botëror dhe për të dhënë përmes vizatimit reagimin e tij instiktiv ndaj kryeveprave...

A

ARTE PAMORE



Opinion *i* Ditës

Protesta për teatrin — mendime të shkurtisura

Nga Ardian Vehbiu


(vijon nga faqja 1)

... ku të riprodohet teatri i mohuar. Kjo edhe ngaqë në krye të protestës kanë dalë aktorët: Aktori në rolin e protestuesit është aktori që e vazhdon teatrin në rrugë. Aktori që proteston deri dje njihet nga publiku duke mos qenë vetja; ndërsa tani konstituohet si person publik, duke luajtur publikun. Lëvizja e tanishme është performim skenik i publikes. Por ka edhe më. Në dinamikën e një shfaqjeje teatrale, aktori zakonisht është ai që e vë lirinë e vet personale në dispozicion të regjisorit.

Në fjalët, emocionet, gjetet dhe lëvizjet e tij aktori është i skriptuar, pa çka se e realizon veten si person mu në distancën e imët mes tekstit (kodit) dhe njeriut (teje si spektator). Por aktori që proteston për teatrin, e ka refuzuar tashmë regjisorin. Tek ky aktor refuzues, publiku sheh të manifestuar veten, në dramën e sotme të politikës.

Lëvizja e tanishme nuk është thjesht për të shpëtuar një ndërtesë, as për të mbrojtur një truall publik nga abuzimi. Është më shumë se kaq: është kryeritje kundër arrogancës së regjisë. Kundër arrogancës, megalomanisë, gënjeshtërisë, vanitetit. Kundër Facebook-izimit të shtetit. Kundër diktaturës së imazhit dhe diktaturës së IMAZHIT (si duam t'i duken Tjetrit). Kundër televizionit. Kundër debateve politike të mbremjes televizive, si karikaturë dhe surrogato e Teatrit. Kundër dizajnit të hapësirës publike si revistë mode. Një diversion i regjisë: të zëvendësojë konflikti i publikut me pushtetin, ashtu siç manifestohet sot në skenën e protestës, me konfliktin mes aktorëve (dhe aktorëve) në skenën e protestës. Atyre që ngrenë zërin në mbrojtje të ndërtesës së teatrit, për vlerat historike, kulturore, simbolike, ose si monument "kulture", u është thënë: teatri nuk është ndërtesa, teatri jeni ju, teatri në bën ju. Por pyetja duhet të jetë: pse ky identifikim kaq tërësor, kaq pasionant i protestës me një ndërtesë? Dhe përgjigja mund të jetë: teatri është vërtet institucion, që përfshin edhe skenën, edhe performimin e aktorëve, edhe pjesën teatrale që luhet, edhe ndërtesën.

Por Teatri — me T të madhe — sot në Shqipëri është më shumë kujtim, nostalgji dhe premtim, sesa art aktiv për publikun. Prandaj edhe ndërtesa lidh të sotmen dhe të djeshmen shpesh të rindëruar me fantazi; njëllor si aktorët e vjetër, që të kthejnë te përvojat skenike të dikurshme. I quajnë "legjendarë", sepse periudha e protagonizimit të tyre në skenat nuk po kuptohet më. Aktorët e vjetër sot në protestë performojnë nostalgjinë e publikut jo për Realizëm



Socialist, por për skenë, aktorë dhe dramë. Nostalgjinë e publikut për qytet. Në këtë kontekst, ndërtesa e mbijetuar e Teatrit merr edhe atributet e cenotafit për stadiumin e shkalluar nga nofullat arrogante të pushtetit. Dhe për kohët kur Tirana qytet shkonte në stadium, çdo të diel. Ndashja e së dielës: ja edhe një vend tjetër, ku riprodhohej Tirana qytet. Një vend me skenë dhe me publik, ngjashëm me Teatrin. Protesta e sotme është edhe e ndërtesës së vjetruar që kërkon të rikthehet në Teatër.

E vjetra është bene rifugio, për-

ballë së resë që ende nuk bind. Teatri këto 30 vjet: sa e ka marrë pushtetin në pyetje? Sa e ka riprodhuar konfliktin e publikut (dhe të publikes) me ata që parazitohen mbi publikun (dhe publikun)? Si institucion ka lënë për të dëshiruar: Publiku i është treguar, në rastet më të mira, si mund të ishte teatri; por jo më tutje. Prandaj gjakimi për ndërtesën është edhe gjakimi për të mbajtur gjallë premtimin dhe garancinë për Teatër. Te binomi qytet-teatër, kërkon të gjejë vend edhe kryeqyteti; çfarë e kthen përplasjen e tan-

ishme në instancë të konfliktit paradigmatik, në Tiranë, midis qytetit dhe kryeqytetit. Tirana kryeqytet kërkon ta përdorë Tiranën qytet si kopertinë të një broshure për turistë; si vitrinë të dyqani "me valutë".

Pa çka se vitrina është teatër i ngrirë, fotografi në tri përmasa. Aktorët atje shndërrohen në manekinë, drama reduktohet në dëshirë. Performimi katandiset në shit-blerje. Ndërveprimin mes njerëzve e zëvendëson tregu. Teksa horizontalitetin e agoras e zëvendëson vertikaltetin e kullës, si metaforë e hierarkive, shtrësi-imeve sociale; si skenë ku performon pushteti: ekonomik, politik, kulturor. Protesta e tanishme artikulon temat kryesore të konfliktit politik në Shqipëri, pas kolapsit ideologjik të së majtës dhe kolapsit organizativ dhe motivacional të opozitës. Dhe si në çdo protestë me impakt të publiku, edhe këtu shumëçka (në mos gjithçka) do ta vendosë skena.

Në fjalët, emocionet, gjetet dhe lëvizjet e tij aktori është i skriptuar, pa çka se e realizon veten si person mu në distancën e imët mes tekstit (kodit) dhe njeriut (teje si spektator). Por aktori që proteston për teatrin, e ka refuzuar tashmë regjisorin. Tek ky aktor refuzues, publiku sheh të manifestuar veten, në dramën e sotme të politikës.

HOROSKOPI

DASHI

Të pakënaqur nga Hëna, si edhe me Venusin e burgosur në shtëpinë tuaj të dymbëdhjetë, për sot nuk bëhet fjalë për aventura dashurie! Si kompensim, mbështetje e Diellit dhe Plutonit hap rrugën për një miqësi të veçantë, intensive dhe intime.

DEMI

Do të keni krijimtari të shkëlqyeshme në punë. Originaliteti i bashkëngjitet çdo nismë. Nën drejtimin tuaj edhe gjëja më e parëndësishme ka personalitet. Me kolegët formoni një ekip të ngushtë që beson në bashkëpunim dhe që përballat me sfidat.

BINJAKET

Revolucionarë të zemrës, synoni harmoninë që zbut mosmarrëveshjet, duke filluar nga jeta në çift, ku komunikimi bëhet jetik. Dëshirat shumëfishohen nga Venusi kështu që në modë dhe produkte kozmetike do të bëni shpenzime të mëdha.

GAFORJA

Venusi dhe Hëna janë të gatshëm që t'ju inkurajojnë dhe t'ju japin një dozë vetëbesimi! Do të keni marrëdhënie të qetë me ambientin që ju rrethon. Pas një sqarimi, jeta në çift do të bëhet më e ëmbël; partneri do të jetë më pak i ngurtë dhe do të këtë më shumë mirëkuptim.

LUANI

Do të keni momente magjike në punë, ku çdo gjë ecën në përsosmëri, të frymëzuar nga një fillad gjeniu krijues dhe të mbështetur nga shija e juaj estetike. Është dita ideale për ata që merren me modën, bukurinë dhe mirëqenien, por edhe për ata që punojnë për marrëdhëniet me publikun.

VIrgJERESHA

Në çifte do të jeni të lumtur dhe të kënaqur, si në përrallat! Rregulli juaj është të ballafaqoheni për çdo gjë, por pa e ngritur zërin, me dashamirësi dhe diplomaci. Do të vendosni të ndërmerri një udhëtim minutën e fundit, për të festuar një përvjetor dashurie ashtu siç duhet!

PESHORJA

Keni një familje e dashur dhe fëmijët të mirë, por ju mungon diçka, dhe madje shumë: një person nga e kaluara që ende nuk arrini ta harroni. Është e nevojshme të ndryshoni menjëherë dietën. Efektet e para do të jenë të dukshme në lëkurë, e cila do të jetë më e shkëlqyer dhe e butë.

AKREPI

Venusin do ta keni kundra, por nuk ju sjell ndërlikime. Ndërkohë, e mbështetur nga aspekti pozitiv i Hënës, nxjerr në pak interesin reciprok. Do të jeni të lumtur dhe të kënaqur, aq sa të ndryshoni qëndrimin duke iu hapur dhe dëgjuar nevojat dhe dëshirat e partnerit.

SHIGJETARI

Hëna do të jetë e heshtur dhe Venusi do të jetë tekanjor, sot dashuria nuk ecën. Ndërkaj tu ngushëlloj dëshija Diell-Pluton, garantuë të një atmosfere miqësore dhe të shëndrimshe. Financat duhet t'i keni në vëmendje, dhe ju takon juve të bëni vlerësimin e duhur për të mos shpenzuar shumë.

BRICJAPI

Nëse jeni të dashur, do të shkoni pak përtej arsyes: do të bëni sjellje të çuditshme, do të bëni deklarata dramatike, do të argoni ambësi të pakufishme për personin që ju tërheq. Sot do të jeni në humor të mirë dhe do të keni fat në veprimtaritë që ndërmerri.


UJORI

Hëna e zellshme do të jetë duke ju mbikëqyruar, ndërsa Venusi ju rekomandon blerjen e sendeve të shtrenjta, duke ju bindur se prestigji dhe suksesi encin krah për krah. Në punë do të jeni energjik.

PESHQIT

Ndjenjat në çift janë të forta, por përsëri nuk është e mjaftueshme. Nëse partneri përpigjet t'ju fusë në "kurth" duke folur ju për të ardhmen, ju bëni menjëherë një hap para. Do të keni kontakte të shpejta dhe fitimprurëse. Nëse i keni mbyllur punët e javës, vazhdoni përpara me veprimtari të tjera.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementare.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.

37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve.
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrefimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjer.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stilitë e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tilla.

21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë peshqijellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në liter.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.

VERTIKAL


35. Një shkop, thupër.
37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapozonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herëtë pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërdajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
28. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brianinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Di figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		3	8		
	7		5		1
	1	4		7	
			2		
			8		3
2			4		5
3			9	8	
	5			9	
	6	5	3		2

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	1	8	4	2	9	7	5	3
9	7	4	3	8	5	6	1	2
2	5	3	7	1	6	4	8	9
1	4	9	2	6	8	3	7	5
7	3	6	5	4	1	2	9	8
5	8	2	9	3	7	1	6	4
3	9	5	6	7	4	8	2	1
8	2	7	1	9	3	5	4	6
4	6	1	8	5	2	9	3	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Gardhet e mira bëjnë fqinjë të mirë.
- Unë shkruaj në letër atë që kam për të kujtuar. Në vend që ta shpenzoj kohën duke u përpjekur të kujtoj atë që kam shkruar, e shpenzoj në kërkim të letrës që kam shkruar atë që kam për të kujtuar.
- Rregulli i artë: çfarë jep, merr.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

K	U	L	T	M	A	P	L	A	B
R	O	R	E	K	A	S	T	I	L
R	U	L	A	K	T	O	R	I	A
B				K	L	E	O	P	A
I	E	K	I	T	R	E	T	E	S
L	A	M	E	K	E	R	M	A	T
T	E	R	M	A	T	A	R	I	C
O	T	O	S	C	I	R	M	A	
B	R	E	D	H	I	A	I	R	K
I	L	E	I	N	E	P	H	I	L
A	N	A	L	I	T	I	K	E	A
S	E	T	E	S	K	I	C	A	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	K	U	T	E	R	I	T	I	M
A	G	A	R	R	E	N	D	M	I	K
L	E	A	R	E	S	O	I	M	I	T
E	M	I	L	E	A	P	E	I	M	I
E	L	E	D	E	P	O	Z	I	T	A
A	T	E	K	A	P	A	N	O	N	E
L	E	K	A	N	A	R	I	N	E	A
E	S	S	E	N	D	A	M	E	A	N
G	I	P	A	M	I	T	E	M	E	R
M	I	T	K	A	T	E	T	E	T	I
K	O	R	I	K	O	L	L	A		
U	N	A	Z	A	R	E	N	D	O	R
M	I	R	A	N	D	A	B	I	S	H
I	R	A	A	R	M	A	D	H	I	D
T	O	A	P	A	R	T	E	T	U	M
I	N	R	I	M	O	T	E	T	U	M
I	R	D	A	M	A	R	E	T	I	L
I	A	K	O	T	A	N	I	O	L	L
M	K	A	B	I	N	E	T	E	R	A
P	U	R	T	E	K	E	T	N	I	K
P	E	R	S	E	T	E	I	N	T	I
L	A	O	I	G	O	L	A	L	A	
I	H	R	I	P	E	T	E	R	I	K
V	O	L	E	E	N	D	O	R	E	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mënçura

- Sa më shumë i ndershëm njeriu, aq më i keq fati i tij.
- Ai që këshillon dikë në fshetësi, vërtet e ka këshilluar, e ai që këshillon dikë në prani të të tjerëve, vetëm se e ka turpëruar
- Nëse kërkoni të gjejnë një vend ku të gjithë janë të barabartë, shko te varrezat
- Njeriu mund të harrojë se çfarë i keni thënë, por asnjëherë nuk mund të harrojë se si e keni bërë të ndjehet

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

